

# Paketë Ligjore mbi Aftësinë e Kufizuar



Shtojcë  
Dhjetor 2015



# PAKETË LIGJORE MBI AFTËSINË E KUFIZUAR

Botimi i Fondacionit Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Adresa: Rr. "Bogdani" P.15-të, kati 3-të, Tiranë

Tel/Fax: +3554 269426

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

E-mail: [adrf@albmail.com](mailto:adrf@albmail.com)

Paketa Ligjore u realizua me fonde të qeverisë suedeze nëpërmjet bashkëpunimit me Civil Rights Defenders, në kuadër të projektit të zbatuar në vite nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) "Asistencë Ligjore falas për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre".

# Përmbajtja

■ Ligj Nr. 93/2014 për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara .....	5
■ Urdhër Nr. 344, datë 19.8.2013 për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social .....	14
■ Ligj Nr. 47/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.....	16
■ Vendim, Nr. 248, datë 30.04.2014 për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara.....	19
■ Vendim, Nr. 460, datë 9.7.2014 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 248, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara” .....	23
■ Vendim për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor .....	24
■ Vendim Nr. 526, datë 6.8.2014 për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi si për fitues të programeve sociale të strehimit.....	26
■ Vendim Nr. 527, datë 6.8.2014 për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët .....	27
■ Udhëzim Nr. 12, datë 29.9.2014 mbi zbatimin e vendimit Nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	29
■ Udhëzim Nr. 13, datë 29.9.2014 mbi zbatimin e vendimit Nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar.....	30
■ Udhëzim Nr. 14, datë 29.9.2014 mbi zbatimin e vendimit Nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar.....	31
■ Udhëzim Nr. 38, datë 7.10.2014 për kriteret e mësuesit ndihmës me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar .....	32
■ Ligj Nr. 146/2014 për njoftimin dhe konsultimin publik.....	35
■ Vendim, Nr. 837, datë 3.12.2014 Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë .....	43
■ Ligj Nr. 104/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	44
■ Ligj Nr. 119/2014 për të drejtën e informimit.....	62
■ Vendim Nr. 48, datë 21.1.2015 për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për aftësinë e kufizuar .....	74
■ Rregullore e funksionimit të Këshillit Kombëtar për aftësinë e kufizuar.....	75

■ Udhëzim, Nr. 1, datë 2.2.2015 mbi zbatimin e vendimit Nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike.....	81
■ Udhëzim, Nr. 7, datë 25.2.2015, për një ndryshim në udhëzimin Nr. 3, datë 10.3.2014 “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” .....	86
■ Udhëzim Nr. 9, datë 25.2.2015 mbi zbatimin e vendimit Nr.404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë frikse” .....	88
■ Udhëzim Nr. 22, datë 20.08.2015 mbi zbatimin e vendimit Nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” të ndryshuar .....	90
■ Udhëzim Nr. 23, datë 20.08.2015 mbi zbatimin e vendimit Nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar .....	91
■ Udhëzim Nr. 24, datë 20.08.2015 mbi zbatimin e vendimit Nr. 277, datë 18.06.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit, të ndryshuar” .....	92
■ Urdhër Nr. 343, datë 19.8.2013 për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar .....	93

# LIGJ

**Nr. 93/2014**

## **PËR PËRFSHIRJEN DHE AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Objekti**

Objekt i këtij ligji janë:

- a) përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët;
- b) përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;
- c) përcaktimet për mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nevojave për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si do të sigurohet kjo mbështetje.

#### **Neni 2 Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundur pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

- b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të bara-bartë në shoqëri.

### **Neni 3 Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.
2. “Ndhimësi personal” është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.
3. “Pengesat” nënkupton:
  - a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
  - b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
  - c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
  - ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.
4. “Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.
5. “Mjetet ndihmëse” është një pajisje ose një sistem produktesh që mund të modifikohet ose të përshtatet dhe të përdoret për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara për kapërcimin e pengesave dhe për të përmirësuar mundësitë e tyre për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë.
6. “Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
7. “Organizatë e personave me aftësi të kufizuara” është çdo organizatë jofitimprurëse, ku personat me aftësi të kufizuara ose prindërit e tyre kanë shumicën e cilësuar në vendimmarrje.
8. “Organizatë për personat me aftësi të kufizuara” është çdo organizatë jofitimprurëse, që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitetet në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.
9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.
10. “Përfshirje” është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.



11. “Përshtatje e arsyeshme” është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

## **Neni 4 Parimet**

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohej se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;
- c) autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara;
- c) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve;
- d) përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;
- dh) pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;
- e) qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t’i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete;
- ë) realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerri masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

## **KREU II JETESA E PAVARUR**

### **Neni 5 Jetesa e pavarur**

1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.
2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:
  - a) në strehim të përshtatshëm dhe të jetojnë ku dhe me kë të dëshirojnë;
  - b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën dëshirojnë;

- c) në një treg gjithëpërfshirës të punësimit;
- ç) në qendra kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike;
- d) në shërbime shoqërore;
- dh) në qendra aftësimi dhe rehabilitimi;
- e) në shërbime shëndetësore përmes infrastrukturës së përshtatshme;
- ë) në transport;
- f) në komunikim dhe informacion;
- g) në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur;
- gj) në aktivitete biznesi e sipërmarrjeje.

## **Neni 6**

### **Shërbimet për një jetesë të pavarur**

1. Jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen: asistenca personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesue-shmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendim-marrja e mbështetur.
2. Shërbimet që mundësojnë jetesën e pavarur kanë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:
  - a) fokusohen në nevojat e individit dhe në zgjedhjet e tij personale;
  - b) mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar;
  - c) krijohen në formën e një shërbimi kontraktual ndërmjet individit me aftësi të kufizuara dhe ofruesit të shërbimit;
  - ç) janë nën kontrollin e personit me aftësi të kufizuara në cilësinë e konsumatorit;
  - d) kanë procedurë të qarta dhe transparente ofrimi;
  - dh) përfshijnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të dhënë udhëzime;
  - e) japin mundësinë për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë që të mësojnë gradualisht si të japin udhëzime;
  - ë) synojnë zhvillimin e plotë të personalitetit të personave me aftësi të kufizuara në respekt të diversitetit.
3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 7**

### **Vendimarrja e mbështetur**

1. “Vendimarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.
2. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet

gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 8 Ndhmësi personal**

1. Ndhmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe në të dëgjuar.
2. Personat me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme, përfitojnë formim për të mësuar se si t'i udhëzojnë ndihmësit personalë.
3. Mënyrat e përfitimit të formimit të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përcaktohen në një udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar.
4. Mënyra e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 9 Mjetet ndihmëse**

1. Mjetet ndihmëse u sigurohen personave me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për pajisje të tilla, për të kapërcyer pengesat, bazuar kjo në vlerësimin e bërë nga komisioni, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.
2. Sigurimi i mjeteve ndihmëse rregullohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe koordinohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

## **KREU III VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE NEVOJAVE PËR NDIHMË E MBËSHTETJE**

### **Neni 10 Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje**

1. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar realizohet nga komisionet multidisiplinare. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete dhe për kujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.
2. Komisionet multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje ngrihen dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.
3. Komisionet janë të pavarura në vlerësimin dhe në punën e tyre. Ky vlerësim bëhet bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar për Funkcionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetit.
4. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet strukturave të saj, kryen:
  - a) kontrollin e zbatimit të rregullave dhe procedurave të veprimtarisë së komisionit;

- b) bashkërendimin e punës me ministrinë përgje-gjëse për çështjet e shëndetësisë për të realizuar trajnimin e anëtarëve të komisioneve e të personelit mbështetës për metodat bashkëkohore të vlerësimit dhe për mjetet mbështetëse që disponohen.
5. Ngritja, administrimi, procedurat e vlerësimit, organizimi e funksionimi i komisionit dhe ankimet e vendimeve rregullohen me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

## **KREU IV FINANCIMI I AKSESUESHMËRISË**

### **Neni 11 Financimi i aksesueshmërisë**

1. Nevojat për asistencë dhe mbështetje, në kuptim të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, mbështeten nga Buxheti i Shtetit. Planifikimi i fondeve të nevojshme për këtë qëllim është kompetencë e ministrisë përgjegjëse në koordinim me ministrinë e linjës për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe bazohet në udhëzime të marra nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
2. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, marrin gradualisht masat për sigurimin e fondeve të nevojshme për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike.
3. Masat për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **KREU V INSTITUCIONET**

### **Neni 12 Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar**

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e kufizuar është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara. Ata emërohen nga Kryeministri me propozim të gjithë organizatave dhe lirohen me urdhër të Kryeministrit. Përzgjedhja e tyre bëhet duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirjes së kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjinisë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në ushtrimin e detyrave të tij mbështetet nga sekretariati teknik i aftësisë së kufizuar pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar.

Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

### **Neni 13**

#### **Detyrat e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar**

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar ka këto detyra:

- a) këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- b) i propozon ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- c) vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërinë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;
- ç) analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;
- d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
- dh) shërben si organ konsultimi për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e komisioneve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje;
- e) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
- ë) jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe përpunimin e tyre.

### **Neni 14**

#### **Bashkërendimi i veprimtarive për problemet e personave me aftësi të kufizuara**

1. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar, pranë tyre.
2. Nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë që politikat e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

### **Neni 15**

#### **Organizatat jofitimprurëse me të drejtë për t'u konsultuar**

1. Subjektet, që marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, janë:
  - a) individit me aftësi të kufizuara;
  - b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara;

- c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara;
  - ç) organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në kuptim të nenit 13 të këtij ligji.
2. Çdo organizatë jofitimprurëse, që pretendon se i është mohuar e drejta për t'u konsultuar apo se është përjashtuar pa të drejtë nga proceset konsultuese, ka të drejtë të ankohet, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.

### **Neni 16 Monitorimi**

1. Avokati i Popullit, monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8328, datë 30.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

## **KREU VI MBËSHTETJA PËR ZBATIM**

### **Neni 17 Të dhënat dhe statistikat**

1. INSTAT-i dhe strukturat përgjegjëse mbledhin të dhëna të përshtatshme statistikore dhe kërkimore, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave, për të mundësuar politika dhe planifikime të aksesueshme dhe përfshirëse.
2. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë. Llojshmëria e periodiciteti i mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 18 Imazhi publik dhe ndërgjegjësimi**

1. Qeveria nxit një model bashkëkohor të aftësive të kufizuara dhe të dëmtimit, duke rritur ndërgjegjësimin për barazinë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht duke theksuar mjetet për mbështetje dhe ndihmë për të siguruar mundësi dhe kushte të barabarta me të tjerët.
2. Media publike dhe private nxit përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet imazheve që theksojnë mosdiskriminimin, autonominë e personave me aftësi të kufizuara dhe sigurojnë mundësitë që këta persona të flasin vetë për veten e tyre.
3. Qeveria rrit ndërgjegjësimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre në shoqëri me fushata ndërgjegjësuëse.

## **Neni 19**

### **Formatet e aksesueshme**

Ky ligj, ligje të tjera dhe aktet nënligjore përkatëse, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht me të drejtat dhe përfitimet e posaçme të personave me aftësi të kufizuar është i disponueshëm në format të aksesueshëm, i cili është printimi dhe botimi i teksteve në Braille, printim me shkronjë të madhe, në gjuhë të thjeshtuar, të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

## **KREU VII**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

#### **Neni 20**

##### **Ndryshimet në legjislacion**

Bazuar në këtë ligj, institucionet përgjegjëse ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar, veçanërisht me autonominë dhe të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur dhe me përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.

#### **Neni 21**

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 3, dhe 17, pika 2, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, dhe 11, pika 3, brenda 6 muajve, si dhe aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 3, 7, pika 3, 10, pika 5, dhe 20, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
2. Ngarkohet ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të pikës 3, të nenit 8, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

#### **Neni 22**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.7.2014

KRYETARI  
**Ilir Meta**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES**  
**MINISTRI**

**URDHËR**

**Nr. 344, datë 19.8.2013**  
**PËR NGRITJEN E NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 20 të ligjit nr. 69/2012, date 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR)/Zyra Arsimore Rajonale (ZA) të organizojë ngritjen e Njesisë së Shërbimit Psiko-Social.
2. Shërbimi Psiko-Social (SHPS) vlerëson gjendjen psiko-sociale të nxënësve me probleme të të nxënësve ose të sjelljes dhe, në bashkëpunim me mësues e drejtues të institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve.
3. Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në Njësinë e SHPS-së është brenda numrit të punonjësve buxhetorë të miratuar me vendimin nr. 160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e numrit të punonjësve për vitin 2008 në ministritë dhe institucionet qendrore”, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
4. Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në një SHPS për një DAR/ZA, përcaktohet nga numri i nxënësve në institucionet arsimore (kopshte, shkolla) në juridiksionin e DAR/ZA-së dhe normave të SHPS-së.
5. SHPS-ja ofrohet sipas këtyre normave:
  - a) Në kopshtet dhe shkollat e arsimit bazë: Një psikolog dhe një punonjës social për 3000-3500 nxënës;
  - b) Në shkollat e arsimit të mesëm të lartë: Një psikolog dhe një punonjës social për 2800-3500 nxënës;
  - c) Në shkollat me arsim fillor dhe arsim të mesëm: Një psikolog dhe një punonjës social për 2500-3000 nxënës;
  - d) Në shkollat e arsimit special: Një psikolog dhe një punonjës social për 200 nxënës;



6. Psikologu/punonjësi social ka formim fillestar dhe të thelluar si vijon:
  - a) Psikologu: Diplomë universitare “Bachelor” në degën e “Psikologjisë”, si dhe studime “Master shkencor” në “Psikologjinë shkollore” ose “Psikologji klinike”, ose “Master profesional” “Këshillim psikologjik” ose në drejtime të tjera të përafërta;
  - b) Psikologu: Vetëm diplomë universitare “Bachelor” në “Psikologji”. Psikologu duhet që, brenda 3 viteve nga data e fillimit të punës, të kryejë studime të thelluara në nivelin master shkencor ose profesional në degën e “Psikologjisë”;
  - c) Punonjësi social: Diplomë universitare “Bachelor” në degën e “Punës Sociale” dhe studime “Master profesional” në “Punë sociale” ose “Çështje të fëmijës dhe familjes” në drejtime të tjera të përafërta.
  - d) Punonjësi social: Vetëm diplomë universitare “Bachelor” në “Punë Sociale”. Punonjësi social duhet që, brenda 3 viteve nga data e fillimit të punës të kryejë studime të thelluara në nivelin “Master shkencor” apo “Profesional” në degën e “Punës sociale”.
7. Titullari i DAR/ZA-së emëron psikologun/punonjësin social në Njësinë e SHPS-së me konkurrim të hapur, sipas procedurave të emërimit të specialistëve të DAR/ZA-së.
8. Drejtuesi i Njësisë së SHPS-së është psikolog ose punonjës social dhe emërohet nga titullari i njësisë arsimore vendore pas propozimit të dy kandidatëve të përzgjedhur me votim të fshehtë nga specialistët (psikologët/punonjësit socialë) të Njësisë së SHPS-së.  
Në përshkrimin e punës së drejtuesit caktohet koha në rolin e drejtuesit dhe koha si psikolog ose punonjës social në institucionet arsimore publike.
9. Titullari i DAR/ZA-së, pas këshillimit me kryetarin e Njësisë së SHPS-së, cakton institucionet arsimore për çdo psikolog/punonjës socialë të Njësisë.
10. Një psikolog/punonjës social mund të mbulojë një ose disa kopshte ose shkolla në varësi të numrit të nxënësve të këtyre institucioneve arsimore.
11. Njësia e SHPS-së ka në strukturën e saj supervisorin e psikologëve/punonjësve socialë, i cili ka për detyrë kryesore asistencën profesionale të tyre.
12. Njësia e SHPS-së, që ka më shumë se 30 psikologë/punonjës socialë ka një supervisor të psikologut dhe një supervisor të punonjësit social.  
Njësia e SHPS-së, që ka më pak se 30 psikologë/punonjës socialë ka një supervisor të psikologut dhe punonjësit social.  
Në përshkrimin e punës së supervisorit caktohet koha në rolin e supervisorit dhe koha si psikolog ose punonjës social në institucionet arsimore publike.
13. Supervisor propozohet nga drejtuesi i SHPS-së dhe miratohet nga titullari i DAR/ZA-së.
14. Supervisor i psikologëve duhet të ketë një diplomë master në “Psikologji” dhe të paktën 5 vite punë si psikolog shkollor.  
Supervisor i punonjësve socialë duhet të ketë një diplomë master në “Punë sociale” dhe të paktën 5 vite punë si punonjës social. Në njësitë e SHPS-së me më pak se 30 specialistë, supervisor duhet të ketë një diplomë master në “Psikologji” dhe të ketë të paktën 5 vite punë si psikolog shkollor. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

**Myqerem Tafaj**

## **LIGJ**

**Nr. 47/2014**

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005, "PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

#### **Neni 1**

Në nenin 1, pika 1, pas fjalëve "ruajtjen e integritetit" shtohen fjalët "e përfshirjen shoqërore për".

#### **Neni 2**

Në nenin 4, pika 13 ndryshohet si më poshtë: "13. "Të ardhura të familjes" janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, përfshirë dhe ata anëtarë që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes me aftësi të kufizuar, në kuptim të këtij ligji."

#### **Neni 3**

Në nenin 5, pika 5 ndryshohet si më poshtë: "5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, përfitojnë sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 3, të këtij ligji."

## Neni 4

Në nenin 9, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Personat që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie.

5. Personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e Buxhetit të Shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar.”.

## Neni 5

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë: “2. Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 24 muajsh punësimi. Procedurat në rastet e rikthimit në skemën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

## Neni 6

1. Në nenin 20 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: 1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore publikon, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, listën e plotë të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar.”.
2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë: “2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga:
  - a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes;
  - b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë.

Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar ndihmë ekonomike paraqiten tek administratori shoqëror në njësinë e qeverisjes vendore.

Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe nivelet minimale dhe maksimale të masës për përfitimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

## Neni 7

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pas fjalëve “Buxhetit të Shtetit” shtohen fjalët “duke përfshirë edhe shpenzimet e shërbimit shëndetësor/mjekësor”.

Paragrafi i parë numërtohet pika “1” dhe, pas saj, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje: “2. Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit.”.

## Neni 8

Pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me këtë përmbajtje:

### “Neni 41/1

Ankimi për përfitimin e ndihmës ekonomike

1. Aplikuesi, për përfitimin e ndihmës ekonomike në zonat pilot, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit

përkatës është i padrejtë, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Ankesat bëhen brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit. Organi i njësisë së qeverisjes vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 5 ditëve pas marrjes së ankesës.

2. Aplikuesi, për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi i marrë nga organi i qeverisjes vendore nuk është i drejtë, i paraqet ankesë me shkrim drejtorit të zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Ankesat dorëzohen brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga njësia e qeverisjes vendore.
3. Drejtori i zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesës, njofton me shkrim për vendimin e marrë aplikuesin dhe njësinë e qeverisjes vendore, për përfitimin e ndihmës ekonomike, brenda 10 ditëve pas marrjes së ankesës.”.

### **Neni 9**

Në nenin 42/1, fjalia e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Kërkesa për të përfituar ndihmën ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes/individit në nevojë.”.

### **Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

**Ilir Meta**

Miratuar në datën 24.4.2014

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**Vendim**

**Nr. 248, datë 30.04.2014**

**Për**

**PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PERSONAVE  
ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

Vendosi:

1. Zyra përkatëse e punësimit financon për punësimin e personave me aftësi të kufizuara:
  - a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në degën e sigurimeve shoqërore sipas procedurave përkatëse.
  - b) Punëdhënësin, me një financim për të pajisuar siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuar dhe për t’i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona. Për këtë, punëdhënësit duhet të paraqesin një projekt për përshtatjen e arsyeshme.
  - c) Punëmarrësin, punëkërkesin e papunë person me aftësi të kufizuar, sipas këtij programi, me një financim mujor në masën deri 100 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e parë të punësimit;
  - c) Punëmarrësin, punëkërkesin e papunë person me aftësi të kufizuar, me një financim mujor në masën deri në 50 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e dytë të punësimit.
2. Zyra përkatëse e punësimit financon për formimin në punë të personave me aftësi të kufizuara:
  - a) Punëdhënësin, deri në 70 për qind të tarifave me bazë koston e trajnimit;

- b) kursantin, punëkërkuessin e papunë, të përfshirë sipas këtij programi, në masën deri në 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi;
  - c) derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.5 për qind të pagës minimale, i cili derdhet në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse.
3. Pas përfundimit të kontratës së punës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, në rastin e vazhdimit të punësimit me kontratë, punëdhënësi ka të drejtë të riaplikojë për këtë program në vitin pasardhës, pas shprehjes së vullnetit të të dyja palëve për zgjatjen e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.
  4. Pas përfundimit të kontratës së punës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, në rastin e vazhdimit të punësimit me kontratë dhe me pagesë të plotë nga ana e punëdhënësit, në lidhje me pagesat e aftësisë së kufizuar zbatohet legjislacioni në fuqi.
  5. Kohëzgjatja e programit të formimit në punë, sipas pikës 2, të këtij vendimi, është jo më shumë se 6 (gjastë) muaj për të gjitha profesionet. Në përfundim të periudhës së formimit, punëdhënësit duhet të punësojnë jo më pak se 30 për qind të të trajnuarve, për një periudhë 6-mujore.
  6. Pjesëmarrësit në formim, sipas pikës 2, të këtij vendimi, duhet të jenë persona të pakualifikuar profesionalisht.
  7. Tarifat për kostot e formimit nëpërmjet punës vendosen nga komisioni i përcaktuar në vendimin nr.47 datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë", të ndryshuar.
  8. Punëkërkuessit e papunë me aftësi të kufizuara të përfshirë në program sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, nuk e humbasin pagesën që përfitojnë për shkak të aftësisë së kufizuar.
  9. Një punëdhënës mund të aplikojë për të përfituar financimin e përcaktuar sipas pikës 1 ose sipas pikës 2, të këtij vendimi, por jo për të dyja pikat njëkohësisht.
  10. Financimi sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, ndërpritet në rastin kur punëdhënësi, pas përfitimit të financimit, në zbatim të këtij vendimi, zgjidh pa shkaqe të arsyeshme kontratat e punës së punëmarrësve të tjerë, të punësuar pranë tij.
  11. Zyra përkatëse e punësimit bën njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfitimit nga ky program. Publikimi i programit bëhet gjithashtu me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.
  12. Punëdhënësi që aplikon për programin e punësimit nuk duhet të ketë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës dhe duhet të ketë derdhur, rregullisht, tatimet e sigurimet e detyrueshme shoqërore, për aq kohë sa kryen veprimtarinë.
  13. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit, ku ai zhvillon veprimtarinë, dokumentacionin e mëposhtëm:
    - a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik apo fizik ose vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
    - b) Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);
    - c) Vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që lëshohen nga organi tatimor përkatës, për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, për subjektet me kohëzgjatje aktiviteti më pak se një vit, dhe për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit, për subjektet me kohëzgjatje aktiviteti prej më shumë se një viti;
    - ç) Numrin e llogarisë bankare;
    - d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

dh) Informacion për:

- i) numrin e fuqisë punëtore;
- ii) listën e të siguruarve;
- iii) llojin e veprimtarisë që kryen;
- iv) nivelin e pagës së dhënë, për çdo person;
- v) planbiznesin për shtimin e fuqisë punëtore.
- vi) akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

14. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.
15. Zyra përkatëse e punësimit ia paraqet këshillit vendor tripalësh, të ngritur pranë saj, projektet që kërkohen të zbatohen aty ku ajo ushtron veprimtarinë, i cili, pasi shqyrton dhe vlerëson dobinë social-ekonomike të tyre, i miraton ato në parim.
16. Pas miratimit, në parim, të projekteve në këshillin vendor tripalësh, zyra përkatëse e punësimit a dërgon, për miratim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
17. Për zbatimin e pikës 15, të këtij vendimi, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve, me jo më pak se 5 (pesë) persona. Mënyra e organizimit, vlerësimit të projekteve dhe e funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve përcaktohen në rregulloren e këshillit administrativ tripalësh të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
18. Komisioni miratimit të projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos miratimin ose jo të projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.
19. Për projektet e miratuara, zyra përkatëse e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuesve të papunë persona me aftësi të kufizuara, që do të përfshihen në program.
20. Ndërmjet zyrave përkatëse të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin, për secilën palë. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor për të cilin është miratuar projekti. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë, në përputhje me fondet e miratuara atë vit.
21. Punëdhënësi dhe punëkërkuesi si punëmarrës, nënshkruajnë një kontratë individuale pune, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe në këtë vendim. Një kopje e kontratës së punës së çdo punëkërkuesi punëmarrës, depozitohet në zyrën përkatëse të punësimit, e cila ndjek zbatimin e kontratës deri në përfundim të projektit.
22. Në rastet kur punëkërkuesi si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë, për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas njoftimit nga punëdhënësi për shkaqet e zgjidhjes së kontratës.
23. Nëse punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme bën zgjidhjen e kontratës së punës me punëkërkuesin e punësuar, është  detyruar ta kthejë të gjithë financimin e marrë për punëkërkuesin e punësuar, që nga data e parë e dhënies së tij, së bashku me interesat, të llogaritura sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.
24. Kontratat tip, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 20 e 21, të këtij vendimi, hartohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga zyrat përkatëse të punësimit.
25. Shërbimi Kombëtar i Punësimit analizon efektshmërinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
26. Shërbimi Kombëtar i Punësimit ruan të dhënat për skemën deri në 10 (dhjetë) vjet, pas dhënies së fundit të ndihmës individuale.



27. Programi vlerësohet, në vitin pasardhës, nga ekspertë ose organizata të pavarura që kanë përvojë në këtë fushë dhe njohuri për tregun e punës.
28. Kostoja dhe vlerësimi i këtij programi përballohen nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, zëri “Nxitja e punësimit”, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
29. Skema të fillojë të zbatohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe kohëzgjatja e saj të jetë 5 (pesë) vjet.
30. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit, dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e programit nëpërmjet zyrave të punësimit.
31. Vendimi nr.353, datë 24.4.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Kryeministri  
**EDI RAMA**



## VENDIM

**Nr. 460, datë 9.7.2014**

### **PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 248, DATË 30.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 248, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën "a" të pikës 1, fjalët "... në degën e sigurimeve shoqërore ..." zëvendësohen me "... në degën përkatëse të tatimeve ...".
2. Në fund të shkronjës "d" të pikës 13, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:  
"Bëjnë përjashtim nga ky rregull personat juridikë/fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por në momentin e aplikimit në këtë program:
  - i) kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;
  - ii) kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjrobat;
  - iii) kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore. Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

## VENDIM

### PËR

# LLOJET, PERIODICITETIN DHE MËNYRËN E RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE STATISTIKORE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR NGA STRUKTURAT SHETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr.93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas fushave ku operojnë, me qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.
2. Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave nga institucionet, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave, për garantimin e konfidencialitetit dhe për respektimin e jetës private të tyre. Këto të dhëna janë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar.
3. Institucionet e pavarura, bazuar në funksionimin e tyre, i dërgojnë, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, krijuar pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar.
4. Institucionet e administratës shtetërore, bazuar në funksionimin e tyre, i dërgojnë, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Bashkitë u dërgojnë, periodikisht, nëpunësve që mbulojnë çështjet e aftësisë së kufizuar, në qarkun përkatës, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Qarku përpunon të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, të përcjella nga bashkitë, pjesë e tij, dhe ia përcjell ato, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
7. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, përpunon të dhënat e grumbulluara, nëpërmjet sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

8. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, monitoron përditësimin progresiv të të dhënave, sipas treguesve të përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit. Të dhënat janë pjesë e raportit që sekretariati teknik dërgon te të gjithë anëtarët e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.
9. Sekretariati teknik për aftësinë e kufizuar i dërgon të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara, sipas pikave 3-8, të këtij vendimi, në Institutin e Statistikave (INSTAT).
10. Instituti i Statistikave bën anketime të dedikuara për çështjet e aftësisë së kufizuar. Rezultatet e anketimeve i bën publike dhe informon, zyrtarisht, ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
11. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Kryeministri  
**EDI RAMA**

Në mungesë dhe me porosi  
Zëvendës Kryeministri  
**NIKO PELESHI**

## VENDIM

**Nr. 526, datë 6.8.2014**

### **PËR KATEGORITË E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË TRAJTOHEN ME PËRPARËSI SI PËRFITUES TË PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “i”, të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë përparësi për t’u trajtuar si përfitues të programeve sociale të strehimit kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, në kuptim të ligjeve nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, të grupuar si më poshtë vijon:
  - a) Të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët, sipas kriterëve mjekësorë, janë të paaftë për punë në kushte normale;
  - b) Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshja;
  - c) Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë;
  - ç) Personat të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas statusit të invalidit të punës.
2. Kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, u jepet prioritet duke i pikëzuar në formatin tip të sistemit të pikëzimit, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore për çdo program strehimi dhe që shërben për klasifikimin e kërkesave për strehim nga organet e qeverisjes vendore.
3. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri

**Edi Rama**

## **VENDIM**

**Nr. 527, datë 6.8.2014**

### **PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, KRITEREVE DHE PËRPARËSIVE PËR PËRFITIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive që zbatohen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe organet qendrore për akordimin dhe përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët.
2. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 30 janar të çdo viti, paraqesin kërkesat për grante të menjëhershme për banesat me kosto të ulët, pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje.
3. Ministria, brenda muajit mars, planifikon në buxhetin e shtetit fondet për vitin pasardhës për grantet e menjëhershme, bazuar në kërkesat vjetore të bashkive, sa herë që zbatohen programe të banesave me kosto të ulët.
4. Njësitë e qeverisjes vendore gjatë hartimit të listave të përfituesve, u japin përparësi kategorive të përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, duke pikëzuar këto kategori në formatin tip të sistemit të pikëzimit, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, për programin e banesave me kosto të ulët, dhe që shërben për klasifikimin e kërkesave për strehim nga organet e qeverisjes vendore.
5. Kriteret dhe përparësitë për përfitimin e grantin të menjëhershëm janë këto:
  - a) Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, si më poshtë vijon:
    - i) persona me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët, sipas kriterëve mjekësore, janë të paaftë për punë në kushte normale dhe që kanë nevojë për kujdestarë;
    - ii) paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilët, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, deklarohen se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha e që kanë nevojë për kujdestarë;
    - iii) persona me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë nevojë për përkujdesje;

- b) Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.
6. Familjet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, përfitojnë grantin e menjëhershëm, përkatësisht, në masën:
- a) 5 për qind të vlerës së banesës me kosto të ulët, familjet e përmendura në shkronjën “a” të pikës 5, me të ardhura maksimale mujore nga 100-120 për qind të të ardhurave mesatare të përcaktuara për prefekturën;
  - b) 10 për qind të vlerës së banesës me kosto të ulët, familjet e përmendura në shkronjën “a” të pikës 5, me të ardhura maksimale mujore nga 0-99 për qind të të ardhurave mesatare të përcaktuara për prefekturën;
  - c) 10 për qind të vlerës së banesës me kosto të ulët, individët me statusin e jetimit, të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 5.
7. Në të ardhurat maksimale mujore të familjes nuk përfshihen të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike.
8. Familjet që plotësojnë kriteret sipas pikës 5, të këtij vendimi, paraqesin pranë njësive të qeverisjes vendore kërkesën për përfitimin e grantit të menjëhershëm, në çastin e paraqitjes së dokumentacionit sipas vendimit nr. 574, datë 29.8.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”.
9. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri

**Edi Rama**

## **UDHËZIM**

**Nr. 12, datë 29.9.2014**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, dtë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind lekë në muaj).
2. Masa e përfitimit për kujdestarinë e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10 400 (dhjetëmijë e katërqind) lekë në muaj.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtator i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
4. Udhëzimi nr. 5, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
**Erion Veliaj**

## **UDHËZIM**

**Nr. 13, datë 29.9.2014**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar,

#### UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10 400 (dhjetëmijë e katërqind) lekë në muaj për kujdestarin.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
4. Udhëzimi nr. 6, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
**Erion Veliaj**



## **UDHËZIM**

**Nr. 14, datë 29.9.2014**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT", TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 277, datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar

#### UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 11.250 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.
2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
3. Udhëzimi nr. 7, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2014.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
**Erion Veliaj**

## **UDHËZIM**

**Nr. 38, datë 7.10.2014**

### **PËR KRITERET E MËSUESIT NDIHMËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 65/3 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; nenit 97, kreu XV të Dispozitave Normative të Sistemit Arsimor Parauniversitar,

UDHËZOJ:

#### **KREU I KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE LARGIMIT NGA PUNA TË MËSUESIT NDIHMËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE**

1. Mësuesi ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK) në institucionet arsimore publike duhet të plotësojë këto kritere:
  - a) Të jetë pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit, konform kërkesave të nenit 57, pika 2, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
  - b) Të ketë kryer trajnime të specializuara për trajtimin dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë, që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar.
2. Procedurat e përzgjedhjes së mësuesve ndihmës dhe të largimit nga puna janë në përputhje me udhëzimin nr. 35, datë 30.9.2014 “ Për procedurat e lëvizjes paralele, të emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”.
3. Mësuesi ndihmës mund të punojë, sipas legjislacionit në fuqi, në një ose më shumë institucione arsimore.
4. Norma mësimore javore e mësuesit ndihmës është e njëjtë me atë të mësuesit të zakonshëm në klasë, sipas udhëzimit nr. 21, datë 23.7.2010 të ministrit të Arsimit, “ Për normat e punës mësimore-educative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. Në përcaktimin e

norms merret në konsideratë edhe koha e nevojshme e mësuesit ndihmës për aktivitete planifikuese, bashkëpunuese dhe integruese.

5. Komisioni vlerësues i ngritur pranë njësisë arsimore vendore(DAR/ZA-ve), mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur për çdo nxënës nga institucionet arsimore, vlerëson shkallën e paaftësisë së nxënësit dhe përcakton:
  - a) nevojën për mësuesin ndihmës në klasë;
  - b) nevojën për mësues ndihmës në shtëpi;
  - c) numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënës me aftësi të kufizuar dhe e shënon atë në dosjen e vlerësimit;
  - d) pas çdo vlerësimi (një herë në vit) bën rivlerësim të nevojës së nxënësit për mësues ndihmës.Në bazë të këtij vlerësimi, drejtori i shkollës në bashkëpunim me komisionin e shkollës për fëmijët me AK, përcakton numrin e orëve që një mësues ndihmës do të ketë për çdo fëmijë me AK.
6. Masa e pagesës së mësuesit ndihmës përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

## **KREU II**

### **DETYRAT E MËSUESIT NDIHMËS PËR NXËNËSIT ME AK**

1. Mësuesi ndihmës jep ndihmesën e tij për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik të nxënësve me aftësi të kufizuara (AK).
2. Mësuesi ndihmës bashkëpunon me mësuesin ose mësuesit lëndor, mësuesin kujdestar dhe psikologun /punonjësin social për gjithëpërfshirjen e nxënësve me AK në institucionet arsimore të zakonshme.
3. Mësuesi ndihmës, në bashkëpunim me mësuesin e nxënësit me AK/mësuesit lëndor dhe prindërit, hartojnë dhe vënë në jetë programin edukativ individual (PEI) të nxënësit, të miratuar nga komisioni i shkollës për fëmijët me AK.
4. Mësuesi ndihmës bashkëpunon me mësuesin e lëndës për vlerësimin e nxënësit me AK, sipas objektivave të vendosura në PEI.
5. Mësuesi ndihmës asiston nxënësin me AK sipas nevojave gjatë procesit mësimor si brenda, ashtu dhe jashtë klase, për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tij/saj sa më të plotë në aktivitetet shkollore.
6. Mësuesi ndihmës i kushton vëmendje të posaçme kultivimit të nxënësit me AK të aftësive sociale dhe aftësive të tjera për jetën.
7. Mësuesi ndihmës nxit dhe stimulon kalimin nga varësia në pavarësi të nxënësit me AK.
8. Mësuesi ndihmës ndjek dhe mban shënim aspektet e ecurisë, si dhe ruan e respekton konfidencialitetin e informacionit për nxënësit me AK.
9. Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që veprimtaritë, që zhvillohen në institucionin arsimor dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.
10. Mësuesi ndihmës punon me nxënësit me AK krahas mësuesit në të gjitha orët mësimore vjetore apo në një pjesë të tyre, gjithashtu jashtë klases, me nxënës të veçantë me AK ose me grupe të vogla, duke parapëlqyer grupimet e klasave I- III, IV-VI dhe VII-IX.
11. Mësuesi ndihmës merr pjesë në të gjitha trajnimet e ofruara për zhvillimin e tij profesional me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe arsimit special.
12. Mësuesi ndihmës ose mësuesi kujdestar informon prindërit e fëmijës me AK për shërbimet shtetërore rehabilituese që u ofrohen këtyre fëmijëve.
13. Mësuesi ndihmës raporton në komisionin e shkollës mbi ecurinë e fëmijës dhe realizimin e objektivave.

### **KREU III**

### **DISPOZITAT E FUNDIT**

1. Numri i mësuesve ndihmës mësimorë për çdo njësi arsimore vendore (DAR/ZA) është brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve buxhetorë të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
2. Zbatimi i kriterëve dhe procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit ndihmës, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, janë objekt i inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, dhe drejtoritë e institucioneve arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Arsimit dhe Sportit

**Lindita Nikolla**

# LIGJ

**Nr. 146/2014**

## **PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Objekti**

1. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.
2. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.
3. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

#### **Neni 2 Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.
2. “Akt nënligjor normativ” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron me zbatimin e tij.

3. “Emergjencë civile” është një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.
4. “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.
5. “Konsultim publik” është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.
6. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit.
7. “Njoftim paraprak” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e dhënies së informacioneve ose opinioneve paraprake, përpara fillimit të hartimit të projektaktit.
8. “Njoftim publik” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të projektaktit të propozuar dhe nisja e procedurave të konsultimit publik.
9. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative, çdo organ i pushtetit vendor, që kryen funksione administrative, çdo organ i Forcave të Armatosura e çdo strukturë tjetër, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.
10. “Proces i vendimmarrjes” është proces që përfshin proceset e hartimit e të miratimit nga organet publike të projektakteve.
11. “Projektakt” është projekti i një ligji, projekte të dokumenteve strategjike, kombëtare dhe vendore, të politikave me interes të lartë publik, të hartuara nga organet publike.
12. “Regjistri elektronik” është faqja zyrtare e internetit ku do të publikohen projektaktet, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji.
13. “Rekomandim” është çdo sugjerim, propozim apo mendim me karakter konsultativ për projektaktet e hartuara, i shprehur verbalisht dhe/ose me shkrim nga palët e interesuara.
14. “Takim publik” është çdo takim i hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me këto projektakte, si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre.
15. “Transparencë” është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

### **Neni 3** **Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.

## **Neni 4 Kufizime**

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me:

- a) çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- b) marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrë-veshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- c) aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- ç) aktet normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave;
- d) emergjencën civile;
- dh) çështjet e tjera përjashtimore të parashikuara me ligj.

## **Neni 5 Parimet në procesin e njoftimit e të konsultimit publik**

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik kryhet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- a) transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- b) efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
- c) përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

## **KREU II DETYRIMI PËR NJOFTIM DHE KONSULTIM PUBLIK**

### **Neni 6 Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik**

1. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:
  - a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;
  - b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;
  - c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.
2. Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar. Për konsultime veçanërisht të rëndësishme,

si dhe kurdo që është e mundur, me vendim të organit publik, takimet publike transmetohen në median audiovizive publike për të mundësuar ndjekjen e tyre nga publiku i gjerë.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, organet publike nuk përjashtohen nga detyrimi për publikimin dhe konsultimin e projektakteve, sipas ligjeve të veçanta për funksionimin e tyre.

### **Neni 7**

#### **Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike**

1. Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.
2. Krijimi dhe rregullat e administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

## **KREU III**

### **PALËT E PËRFSHIRA NË KONSULTIMIN PUBLIK**

#### **Neni 8**

##### **Palët e interesuara**

1. Palët e interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik janë:
  - a) organet publike;
  - b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
  - c) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
2. Personat e tjerë të huaj mund të marrin pjesë në procesin e konsultimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ose me kërkesë të drejtpërdrejtë të organeve publike, kur e çmojnë të nevojshme.

#### **Neni 9**

##### **Të drejtat e palëve të interesuara**

Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:

- a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;
- b) t’u propozojnë organeve publike fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga organi publik, në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji;
- c) t’u dorëzojnë organeve publike komente dhe rekomandime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.



## **Neni 10**

### **Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik**

Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.

## **KREU IV**

### **RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK**

#### **Neni 11**

##### **Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve**

1. Njoftimi për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrimit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:
  - a) me postë elektronike;
  - b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;
  - c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
  - ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.
2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.

#### **Neni 12**

##### **Njoftimet paraprake**

1. Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione dhe/ose opinione paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës.
2. Në fazat fillestare, organi publik, kur e gjykon të nevojshme, publikon në një nga format e parashikuara në nenin 11 një njoftim paraprak për aktin që do të hartojë për të siguruar informacione nga palët e interesuara.
3. Çdo palë e interesuar mund t'i përgjigjet njoftimit paraprak brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, duke dorëzuar komente dhe rekomandime.

#### **Neni 13**

##### **Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse**

1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:
  - a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
  - b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
  - c) adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;

- c) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.
2. Aksesimi në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projektaktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

#### **Neni 14**

### **Informacioni që nevojitet të sigurohet**

1. Palët e interesuara që do të konsultohen, pajisen me informacionin e nevojshëm për t'u krijuar atyre mundësinë të kontribuojnë në mënyrën më efektive të mundshme në procesin e përgatitjes së projektaktit në rrugë elektronike dhe/ose postare.
2. Krahas dokumenteve përkatëse, në varësi të kompleksitetit, volumit dhe karakteristikave të tjera të projektaktit, sigurohen shpjegime për qëllimin, problemet që do të trajtohen, idetë e përgjithshme, ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme dhe, për aq sa është e mundur, studime apo analiza që janë kryer për hartimin e projektaktit.

#### **Neni 15**

### **Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve**

1. Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre:
  - a) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak;
  - b) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.
2. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit.
3. Përcaktimet e sipërpërmendura nuk anashkalojnë afatet kohore të përcaktuara në ligje të veçanta për procedurat e konsultimit dhe informimit publik.

#### **Neni 16**

### **Zgjatja dhe përsëritja e fazës së konsultimit**

Organi publik mund të zgjasë afatin për dërgimin e komenteve ose mund të ripërsëritë fazën e marrjes së komenteve e të rekomandimeve në rastet kur:

- a) organi publik nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve të përftuara;
- b) në komentet dhe rekomandimet e dhëna janë ngritur çështje të reja të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimit fillestar.

#### **Neni 17**

### **Njoftimi për takime publike**

1. Gjatë periudhës së konsultimit, nisur nga rëndësia e projektaktit dhe interesi i lartë publik, organi publik mund të organizojë takime publike, ku palët e interesuara paraqesin opinionin e tyre dhe të dhëna për projektaktin që do të hartohet.
2. Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.

## **Neni 18**

### **Pjesëmarrja në takimet publike**

1. Konsultimi në takime publike është i hapur.
2. Njoftimi për organizimin e takimeve publike bëhet sipas mënyrave të njoftimit, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.
3. Përfaqësuesi i organit publik, që drejton takimin, në përputhje me rregullat e organit publik, u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të shprehur mendimin e tyre për çështjet që diskutohen.
4. Në çdo takim publik mbahet procesverbal, i cili arkivohet pranë organit publik.
5. Nëse konsiderohet e nevojshme, takimi publik mund të regjistrohet.
6. Procesverbalet dhe regjistrimet e takimeve publike mund të bëhen publike sipas kërkesës së paraqitur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

## **Neni 19**

### **Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve**

1. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të organit publik përkatës në një mënyrë të strukturuar dhe transparente.
2. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara.
3. Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në nenin 11 të këtij ligji.

## **Neni 20**

### **Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes**

1. Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:
  - a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
  - b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
  - c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
  - ç) numrin e takimeve publike të organizuara.
2. Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji.

## **KREU V**

### **KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE**

#### **Neni 21**

##### **Procedurat për shqyrtimin e ankesave**

1. Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen:
  - a) pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, kur projektakti nuk është miratuar ende;
  - b) pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.
2. Organi publik përgjegjës, me marrjen e ankesës, merr masa të menjëhershme për korrigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura në ankesën e palës së interesuar. Në çdo rast, autoriteti publik njofton palën e interesuar për masat e marra dhe e fton të japë komentet dhe rekomandimet për projektaktin.
3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve. Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
4. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioneri, kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.

## **KREU VI**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 22**

##### **Dispozita përfundimtare**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

#### **Neni 23**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.  
Miratuar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8793, datë 18.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
**Bujar Nishani**

## VENDIM

**Nr. 837, datë 3.12.2014**

### **PËR NJOHJEN E GJUHËS SË SHENJAVE NË REPUBLIKËN SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 18 e 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 4, 5, 9, 13, 21, 24 e 30, të Konventës së Kombeve të Bashkuara Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ratifikuar me ligjin nr. 108/2012, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është autoriteti përgjegjës për koordinimin e procesit të zbatimit të detyrimeve si dhe të vlerësimit e të bashkërendimit të legjislacionit, politikave, programeve për gjuhën e shenjave në Shqipëri dhe çështjeve që lidhen me respektimin e të drejtave të personave që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë.
2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të hartojë platformën me masat për veprim, në zbatim të këtij vendimi, ku të përcaktohen detyrimet për institucionet që duhet të ofrojnë shërbimin e gjuhës së shenjave.
3. Njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë për njerëzit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri  
**Edi Rama**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**LIGJ**

**Nr. 104/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 7703,  
DATË 11.5.1993, "PËR SIGURIMET SHOQËRORE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

**"Neni 1**

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore

Ligji për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga:

- a) sigurimet shoqërore të detyrueshme;
- b) sigurimi shoqëror vullnetar;
- c) sigurimi shoqëror suplementar;
- ç) pensionet shtetërore të posaçme;
- d) pensionet sociale;
- dh) fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar."

## **Neni 2**

Në nenin 2, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt shfuqizohen.

## **Neni 3**

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 4 Sigurimi shoqëror suplementar**

1. Sigurimi shoqëror suplementar mbron me të ardhura:
  - a) Personat që ushtrojnë funksione ose detyra të veçanta kushtetuese dhe personat me tituj shkencorë;
  - b) Punonjësit e shtetit, ushtarakët që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, punonjësit e Shërbimit për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme.
2. Kriteret për sigurim shoqëror suplementar të kategorive, të përfshira në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me ligje të veçanta.
3. Skemë të sigurimit shoqëror suplementar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj të veçantë, ka të drejtë të ngrejë çdo person juridik, me kapital shtetëror ose pjesërisht shtetëror, i autorizuar nga Këshilli i Ministrave.”.

## **Neni 4**

Pas nenit 5 shtohen nenet 5/1 dhe neni 5/2 me këtë përmbajtje:

### **“Neni 5/1 Pensioni social**

Pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat, që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

Masa e pensionit social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruara me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014.

Masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi.

Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 5/2 Fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar**

Krijimi, veprimtaria dhe mbikëqyrja e fondeve profesionale dhe fondeve të pensionit vullnetar bëhen sipas ligjit të veçantë.”.

## Neni 5

Në nenin 9 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Personat e tjerë ekonomikisht aktivë janë të detyruar të paguajnë kontribut mujor për barrë lindje dhe për pensione të llogaritura për një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale kontributive.”.

2. Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.”.

## Neni 6

Në nenin 10, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë ndryshohen si më poshtë:

“Kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi dhe pagës maksimale për efekt kontributi për sigurimet shoqërore, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, e cila është në fuqi në datën 31.12.2014. Pas datës 1.1.2015, paga maksimale për efekt kontributi indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi. Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë dhe llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribut për pension dhe barrë lindje të llogaritur mbi pagën minimale në shkallë vendi. Paga e kontributit bëhet çdo tremujor.”.

## Neni 7

Në nenin 11, pas fjalëve “kontributi vullnetar” shtohen fjalët “llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe”.

## Neni 8

Neni 12 shfuqizohet.

## Neni 9

Në nenin 13, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

- “3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t’i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
4. Kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi dhe kontributet vullnetare derdhen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Kriteret dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Inspektorët e kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të kontrollojnë saktësinë e llogaritjes dhe afatet e pagesës së kontributeve. Çdo diferencë në shumën e kontributeve do të kthehet gjatë 5 vjetëve të pagesës së bashku me kamatëvonesën.”.



## Neni 10

Në nenin 16 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:  
“Masa e kamatëvonesës është sipas përcaktimeve të nenit 76, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.
2. Paragrafi i tretë shfuqizohet.

## Neni 11

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 22 Shuma e të ardhurave**

1. Të ardhurat për sëmundje janë 70 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim dhe 80 për qind kur i siguruari ka mbi 10 vjet sigurim.
2. Për periudhën që përfituesi është shtruar në spital, kur nuk ka njeri në ngarkim, të ardhurat për sëmundje janë 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës.”.

## Neni 12

Në nenin 24, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shuma e së ardhurës, që do të përfitohet për kompensim, është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshme dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës.”.

## Neni 13

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 27 E ardhura për barrëlindje**

1. E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrëlindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm.
2. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijëve.
3. E ardhura për barrëlindje për gruan e siguruar është:
  - a) 80 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga

data e lindjes të së drejtës për pagesë për periudhën e paralindjes dhe për 150 ditë kalendarike pas lindjes;

- b) 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë për periudhën tjetër në vazhdim.
4. E ardhura për barrëlindje për gratë e siguruara si të vetëpunësuar në bujqësi llogaritet sipas pikës 3, të këtij neni. Për periudhën deri në barazimin e kontributeve që paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi me të vetëpunësuarit në aktivitete jobujqësore, e ardhura për barrëlindje caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Nëna, që birëson fëmijën e moshës deri në 1 vjeç dhe që ka qenë e siguar jo më pak se 12 muaj, ka të drejtë për leje pas lindjes, e cila fillon ditën e birësimit, por jo më parë se mbas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës, dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita e lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesen është 28 ditë.
6. Kur një fëmijë është birësuar gjatë lejes së lindjes, nëna që ka lindur do të ketë një periudhë përfitimi deri në ditën e birësimit, por jo më pak se 63 ditë pas lindjes.
7. Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna.”.

#### **Neni 14**

Në nenin 28, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shuma e të ardhurave që do të përfitohet për kompensim është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës të mëparshëm dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës për pagesë.”.

#### **Neni 15**

Në nenin 30 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “b” shfuqizohet.
2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje: “ç/1) pension invaliditeti i reduktuar.”.

#### **Neni 16**

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 31 Pension pleqërie**

1. Personat e siguar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji.
2. Nënata, që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.”.

#### **Neni 17**

Neni 31/1 ndryshohet si më poshtë:

## **"Neni 31/1 Pension pleqërie i reduktuar**

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92, kur:

- a) kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92;
- b) nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më qendror që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, të këtij neni, është 0,6 për qind në muaj.”.

### **Neni 18**

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

#### **"Neni 32 Masa e pensionit**

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.
2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social.
3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji.
4. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.”.

### **Neni 19**

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

#### **"Neni 33 Shtesë pensioni për shtyrje të datës së daljes në pension**

I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas nenit 92, të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 për qind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute.

Përfituesi i pensionit të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes.”.

### **Neni 20**

Neni 34 shfuqizohet.

## **Neni 21**

Në nenin 35, pika 2, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të këtë së paku 12 muaj sigurim shoqëror.”.

## **Neni 22**

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 36 Shuma e pensionit**

1. Shuma e pensionit të invaliditetit të plotë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë.
2. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.”.

## **Neni 23**

Në nenin 38, në fund të fjalisë së parë, fjalët “të bazës së vlerësueshme” zëvendësohen me fjalët “të bazës së vlerësuar neto”.

## **Neni 24**

Në nenin 40, pika 2, shkronja “a”, në paragrafin e fundit shprehja “50 vjeç” zëvendësohet me shprehjen “55 vjeç”.

## **Neni 25**

Në nenin 41, pika 1, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit. Pensioni, që do t’i takonte të ndjerit, llogaritet sipas rregullave për pensionet e invaliditetit. Pensioni familjar jepet në masën:”.

## **Neni 26**

Në nenin 42, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pagesa për rast vdekjeje është e barabartë me 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi.”.

## **Neni 27**

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 43 Llojet e përfitimeve**

Personat e siguruar, në rastet e aksidenteve në punë ose sëmundjeve profesionale, përfitojnë të drejtën e së ardhurës, pavarësisht nga vjetërsia në punë:

- a) për kujdes mjekësor shtesë dhe riaftësimi;
- b) në rast paaftësie;
- c) për kompensim për dëme të arsyeshme;
- ç) në rast vdekjeje.”.

## **Neni 28**

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 47 E ardhura për paaftësi të përkohshme**

E ardhura për paaftësi të përkohshme, si pasojë e një aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, e provuar nga një komision mjekësh ekspertë kompetentë (KML), do të jetë e barabartë me 100 për qind të mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës, paguar për një periudhë përfitimi deri në 12 muaj.”.

## **Neni 29**

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 48 E ardhura për invaliditet të përhershëm**

E ardhura për invaliditet të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 67 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga një Komision Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAAP), është e barabartë me 80 për qind të bazës së vlerësuar mesatare neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës, por jo më pak se 80 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Personit, që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAAP), i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësuar neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës.

Personi, që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, dhe ka në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, përfiton një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit, por jo më shumë se 30 për qind.”.

## **Neni 30**

Neni 49 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 49 E ardhura për invaliditet të pjeshëm të përhershëm**

E ardhura për invaliditet të pjeshëm të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 33 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga KMCAAP-ja, është e barabartë me një pjesë të 80-përqindshmit të bazës mesatare të vlerësuar neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës, në varësi nga shkalla e humbjes së aftësisë për punë, por jo më pak se 50 për qind dhe që përcaktohet në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.”.

## Neni 31

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 59**

#### **Baza e vlerësuar për llogaritjen e përfitimeve**

1. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.  
Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.  
Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.  
Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.  
Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994, si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 1.1.1994.  
Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2015 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese, sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 1.1.1994, si edhe mbi pagat individuale, mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 1.1.1994 deri në 31.12.2014, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2014 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës.  
Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Baza e vlerësuar neto për llogaritjen e pagesave për sëmundje e barrëlindje dhe për të ardhura të tjera afatshkurtra do të jenë pagat mbi të cilat janë paguar kontributet pasi zbritet tatimi mbi të ardhurat personale, norma e kontributit të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare që mbahet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi për periudhën përkatëse.
3. Çdo vit, pas 1.1.2015, duke filluar nga data 1 janar, baza e vlerësuar vjetore individuale indeksohet me koeficientin, që llogaritet si raport i kontributit mesatar të personave të siguruar, të mbledhur në vitin e fundit kalendarik, kundrejt të njëjtit tregues të vitit pararendës. Ky koeficient caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Pensionet e invaliditetit nuk do të llogariten me një bazë të vlerësuar më të ulët se ajo e paguar më parë. Sapo të jetë përfituar një pension invaliditeti, shuma e pensionit do të merret si kufi minimal, kur llogaritet çdo pension tjetër sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.”.

## Neni 32

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:

## **“Neni 61 Indeksimi i përfitimeve**

Pensioni social, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit, familjare si edhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale indeksohen çdo vit për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit.”.

### **Neni 33**

Në nenin 64 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:  
“Pensioni social financohet nga Buxheti i Shtetit.”

### **Neni 34**

Në nenin 66, shkronja “d”, emërtimi “Kuvendi Popullor” zëvendësohet me emërtimin “Kuvendi i Republikës së Shqipërisë”.

### **Neni 35**

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 70 Fondi rezervë**

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën 1 muaj shpenzimet për pensione.
2. Rezerva të plotësohet gjatë 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në çdo rast, kur fondi rezervë është nën nivelin përcaktues, merren masat e nevojshme për ta vendosur në kuotën e caktuar. Procedurat e plotësimit përcaktohen në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore miratuar nga Këshilli i Ministrave.”.

### **Neni 36**

Titulli i nenit 82 ndryshohet si më poshtë:  
“Procedura për transferimin dhe pagimin e kontributeve”.

### **Neni 37**

Në nenin 84, pika 2 ndryshohet si më poshtë:  
“2. Kërkesat, së bashku me dokumentet e përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paraqiten në agjencitë lokale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit.”.

### **Neni 38**

Në nenin 85, pika 2 ndryshohet si më poshtë:



“2. Përfitimet afatshkurtra për papunësinë caktohen nga zyrat e punësimit. Dokumentacioni, kriteret dhe procedurat e caktimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

### **Neni 39**

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 87 Pagesat**

Pagesa e përfitimeve nga sigurimet shoqërore u ngarkohet institucioneve financiare profesionale, që do të caktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Pagesa për përfitimin e papunësisë bëhet nga institucione financiare profesionale ose nga zyrat e punës, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

### **Neni 40**

Neni 88 ndryshohet si më poshtë:

#### **Neni 88 Të drejtat e fituara**

1. Sigurimi shoqëror është jofitimprurës. Me kontributet e derdhura garantohet pagesa në para për të kompensuar pakësimin e të ardhurave në një shumë që mbulon të paktën një standard minimal jetese, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Kur standardi minimal i jetesës nuk arrihet nga pensioni, për pensionistët me datë fillimi deri më 31.12.2014, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë një shtesë të ardhurash në formë kompensimi të plotë.
2. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr. 4171, datë 13.4.1966, “Për sigurimet shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, quhen të mirëqena dhe nuk do të jenë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas pikës 1, të këtij neni.
3. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, me të gjitha ndryshimet e tij të mëvonshme, quhen të mirëqena dhe nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas pikës 1, të këtij neni.
4. Pensionet për personat që u lind e drejta deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje përveç indeksimit dhe kompensimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Pensionet dhe përfitimet e tjera nga sigurimi shoqëror suplementar, të caktuara sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri më 31.12.2014, për kategoritë e përfshira në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Personat, që marrin përfitime afatshkurtra për paaftësi, barrë lindje, sigurim papunësie etj., me datë fillimi përpara datës 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, do ta përfitojnë atë në masën dhe kriteret e përcaktuara në dispozitat që kanë qenë në fuqi deri në atë datë.
7. Personat, të cilët deri në datën 31.12.2014, merrnin pension pleqërie, pension të parakohshëm, pension familjar, pension për vjetërsi shërbimi, pension për vjetërsi shërbimi në raste të veçanta, do të vazhdojnë të tërheqin pensionin e tyre. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për shtesat e dhëna për pjesëmarrjen në luftën kundër pushtuesve nazifashistë.



8. Personat që deri në datën 31.12.2014 përfitojnë pension invaliditeti, do të vazhdojnë ta marrin atë me përjashtim të rastit kur, pas një rivlerësimi të gjendjes shëndetësore, ligji i ri rezulton me kushte më të favorshme.”.

### **Neni 41**

Në nenin 90, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kontributi i të vetëpunësuarve në bujqësi do të rritet gradualisht deri në barazimin me kontributet e personave të vetëpunësuar në aktivitete jobujqësore në vitin 2018. Rritja vjetore e masës së kontributit caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

### **Neni 42**

Në nenin 91, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 1.9.2000 dhe deri më 31.12.2032, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj.

Në këtë rast, kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.”.

### **Neni 43**

Neni 92 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 92**

#### **Zgjatja graduale e moshës dhe periudhës së sigurimit për pension**

1. Moshë dhe periudha e sigurimit për pension pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohet në pikën 1, të nenit 31, të këtij ligji, do të rriten sipas tabelave që vijojnë:

### **MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRROHET NË VITE PËR SECILËN KATEGORI**

#### **BURRI**

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Moshë	Vjetërsia e punës	Moshë	Vjetërsia e punës	Moshë	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29

1999		53	23	58	30	60	30
2000		53	23	58	31	60	31
2001		54	24	59	32	60	32
01.07.2002 30.06.2003	-	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 30.06.2004	-	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 30.06.2005	-	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 30.06.2006	-	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 30.06.2007	-	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 30.06.2008	-	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 30.06.2009	-	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 30.06.2010	-	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 30.06.2011	-	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 30.06.2012	-	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 30.06.2013	-	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 30.06.2014	-	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 31.12.2014	-	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 31.12.2015	-	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 31.12.2016	-	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m
01.01.2017 31.12.2017	-	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 31.12.2018	-	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 31.12.2019	-	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 31.12.2020	-	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021	-	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m

31.12.2021						
01.01.2022 31.12.2022	- 64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 31.12.2023	- 65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 31.12.2024	- 65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 31.12.2025	- 65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 31.12.2026	- 65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 31.12.2027	- 65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 31.12.2028	- 65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 31.12.2029	- 65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 31.12.2030	- 65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 31.12.2031	- 65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 31.12.2032	- 65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039- 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v
01.01.2040- 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	65v 9m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	65v11m	40v	65v11m	40v	65v11m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045-	66v1m	40v	66v1m	40v	66v1m	40v

31.12.2045						
01.01.2046- 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052- 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v11m	40v	66v11m	40v	66v11m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

**MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRROHET  
NË VITE PËR SECILËN KATEGORI**

**GRUAJA**

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 30.06.2003	- 49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 30.06.2004	- 50	24	55	34	56v	34

01.07.2004 30.06.2005	- 50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 30.06.2006	- 51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 30.06.2007	- 51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 30.06.2008	- 52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 30.06.2009	- 52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 30.06.2010	- 53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 30.06.2011	- 53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 30.06.2012	- 54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 30.06.2013	- 54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 30.06.2014	- 55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 31.12.2014	- 55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 31.12.2015	- 56v	35	60v 2m	35v4m	60v2m	35v4m
01.01.2016 31.12.2016	- 56v 6m	35	60v4m	35v8m	60v4m	35v8m
01.01.2017 30.12.2017	- 57v	35	60v6m	36v	60v6m	36v
01.07.2018 30.06.2018	- 57v 6m	35	60v8m	36v4m	60v8m	36v4m
01.01.2019 31.12.2019	- 58v	35	60v10m	36v8m	60v10m	36v8m
01.01.2020 31.12.2020	- 58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 31.12.2021	- 59v	35	61v2m	37v4m	61v2m	37v4m
01.01.2022 31.12.2022	- 59v 6m	35	61v4m	37v8m	61v4m	37v8m
01.01.2023 31.12.2023	- 60v	35	61v6m	38v	61v6m	38v
01.01.2024 31.12.2024	- 60v4m	35v6m	61v8m	38v4m	61v8m	38v4m
01.01.2025 31.12.2025	- 60v8m	36v	61v10m	38v8m	61v10m	38v8m
01.01.2026 31.12.2026	- 61v	36v6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 31.12.2027	- 61v4m	37v	62v2m	39v4m	62v2m	39v4m

01.01.2028 31.12.2028	- 61v8m	37v6m	62v4m	39v8m	62v4m	39v8m
01.01.2029 31.12.2029	- 62v	38v	62v6m	40v	62v6m	40v
01.01.2030 31.12.2030	- 62v4m	38v6m	62v8m	40 v	62v8m	40v
01.01.2031 31.12.2031	- 62v8m	39v	62v10m	40v	62v10m	40v
01.01.2032 31.12.2032	- 63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	63v10m	40v	63v10m	40v	63v10m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039- 31.12.2039	64v2m	40v	64v2m	40v	64v2m	40v
01.01.2040- 31.12.2040	64v4m	40v	64v4m	40v	64v4m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	64v6m	40v	64v6m	40v	64v6m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	64v8m	40v	64v8m	40v	64v8m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	64v10m	40v	64v10m	40v	64v10m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045- 31.12.2045	65v2m	40v	65v2m	40v	65v2m	40v
01.01.2046- 31.12.2046	65v4m	40v	65v4m	40v	65v4m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	65v6m	40v	65v6m	40v	65v6m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	65v8m	40v	65v8m	40v	65v8m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v2m	40v	66v2m	40v	66v2m	40v

01.01.2052- 31.12.2052	66v4m	40v	66v4m	40v	66v4m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v6m	40v	66v6m	40v	66v6m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v8m	40v	66v8m	40v	66v8m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

2. I siguruari ka të drejtë të marrë pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë ose të dytë, pasi ka plotësuar në këtë kategori jo më pak se 3/4 e viteve të sigurimit. I siguruari që ka plotësuar vitet e sigurimit, sipas tabelës së mësipërme, nga të cilat jo më pak se 1/2 ka punuar në nëntokë, ka të drejtë të marrë pension në kushtet e kategorisë së parë.

#### **Neni 44**

Në nenin 93, shprehja “50 vjeç” zëvendësohet me shprehjen “55 vjeç”, ndërsa paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë: “Në rastet kur si vjetërsi pune, sipas kësaj table, kërkohet të njihet edhe vjetërsia si ish-anëtar i kooperativës bujqësore, dhe data e fillimit të pensionit është nga data 1.1.2015 e në vazhdim, masa e pensionit llogaritet sipas neneve 32 dhe 96, të këtij ligji.”.

#### **Neni 45**

Në fund të nenit 95 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Për pensionet me datë fillimi nga 1.1.2015 e në vazhdim ky nen nuk zbatohet.”.

#### **Neni 46**

Në nenin 96 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Të vetëpunësuarve në bujqësi, që plotësojnë kushtet për pension, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund t’u njihen periudhat e së kaluarës, si periudha sigurimi kundrejt pagesës së kontributeve, sipas masës së kontributeve të përcaktuara për vitin kur kryhet pagesa, por jo për periudhat para datës 1.10.1993.”.

2. Pas paragrafit të pestë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për personat, të cilëve e drejta për përfitim u lind në datën 1.1.2015 e në vijim dhe kanë periudha sigurimi në ish-kooperativat bujqësore, si dhe periudha të tjera në marrëdhënie pune me shtetin, apo periudha sigurimi pas vitit 1994, për llogaritjen e pensioneve të pleqërisë do të zbatohen nenet 31, 32, 92 dhe 93, të këtij ligji, ndërsa për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare do të zbatohen nenet 35, 36, 40 dhe 41, të këtij ligji.”.

#### **Neni 47**

Në nenin 98, paragrafi i parë shfuqizohet. Neni 48 Në nenin 99 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda vitit 2014, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.”. Neni 49 Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2015.

Kryetari

**Ilir META**

Miratuar në datën 31.7.2014

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

## LIGJ

### Nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Objekti dhe qëllimi

1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.
2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.
3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

#### Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik”:
  - a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;



- b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve;  
ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike;
- c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.
  - 1. “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.
  - 2. “Person” është çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe personat pa shtetësi.
  - 3. “Të dhëna personale” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndryshuar.
  - 4. “Programe transparence” është tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të këtij ligji.
  - 5. “Koordinator për të drejtën e informimit” është nëpunësi civil i përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

## **KREU II**

### **E DREJTA E INFORMIMIT DHE TRANSPARENCA**

#### **Neni 3**

##### **E drejta e informimit**

- 1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
- 3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
- 4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

#### **Neni 4**

##### **Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës**

- 1. Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.
- 2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:
  - a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
  - b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

## **Neni 5**

### **Rishikimi i programit të transparencës**

1. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
2. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.

## **Neni 6**

### **Programet model të transparencës**

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

## **Neni 7**

### **Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë**

1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:
  - a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
  - b) tekstet e plota:
    - i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;
    - ii) të ligjeve;
    - iii) të akteve nënligjore;
    - iv) të kodeve të sjelljes;
    - v) të çdo dokumenti politikash;
    - vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;
  - c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
  - c) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
  - d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
  - dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
  - e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregullu-

ara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

- ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:
    - i) listën e kontratave të lidhura;
    - ii) shumën e kontraktuar;
    - iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
    - iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
  - f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;
  - g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;
  - gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
  - h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
  - i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;
  - j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato;
  - k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;
  - l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.
2. Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.
3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

## **Neni 8**

### **Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**

1. Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.
2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit.

## **Neni 9**

### **Informacioni i dhënë më parë**

1. Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.
2. Kërkesat për informim për informacione të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve plotësohen jo më vonë se 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës.

## **Neni 10**

### **Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit**

1. Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit.
2. Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme: a) i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij; b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji; c) bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj; ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre; d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar; dh) verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13, të këtij ligji; e) kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të këtij ligji, si dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

## **KREU III**

### **NJOHJA ME INFORMACIONIN PUBLIK**

## **Neni 11**

### **Kërkesa për informim**

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuesit që ka bërë kërkesën për informim.
3. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.
4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit; b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

## **Neni 12**

### **Saktësimi dhe trajtimi i kërkesës për informim**

1. Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës.
2. Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.
3. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.

## **Neni 13**

### **Kostoja e shërbimit**

1. Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.
2. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.
3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrton periodikisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifën e bëra publike nga autoritetet publike dhe, sipas rastit, urdhëron ndryshimin e tyre.
4. Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.
5. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave me udhëzim të përbashkët përcaktojnë numrin e faqeve, për të cilat informacioni përfitohet falas, sipas pikës 4, të këtij neni, si dhe rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës.

## **Neni 14**

### **Mënyrat e dhënies së informacionit**

1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuesit:
  - a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;
  - b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.
3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.
4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

## **Neni 15**

### **Afati për marrjen e informacionit**

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.
3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:
  - a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
  - b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
  - c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.
4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.
5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.

## **Neni 16**

### **Njoftime paraprake për kërkuarin**

1. Në qoftë se autoriteti konstaton se trajtimi i një kërkesë për informim ka kosto të lartë ose se trajtimi i saj kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji, autoriteti publik njofton menjëherë për këtë kërkuarin dhe i propozon mundësinë e ndryshimit të kërkesës së tij.
2. Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuarit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni. Kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkesës, duke i treguar kërkuarit adresën e saktë të faqes ku informacioni gjendet në formë elektronike.
3. Pas marrjes së kërkesës për informim, autoriteti publik llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe, sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuarin. Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.

## **KREU IV**

### **KUFIZIMI I SË DREJTËS PËR INFORMIM**

#### **Neni 17**

##### **Kufizime**

1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:
  - a) të drejtën për një jetë private;
  - b) sekretin tregtar;



- c) të drejtën e autorit;
- ç) patentat.

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:
  - a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
  - b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
  - c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
  - ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
  - d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
  - dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
  - e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;
  - ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë, të pikës 2, të këtij neni, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij neni, nuk zbatohet kur hetimi administrativ, në kuadër të një procedimi disiplinor, dhe procedurat e inspektimit e të auditimit të autoriteteve publike kanë përfunduar.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat “d” dhe “dh”, të këtij neni, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronja “e”, të këtij neni, nuk zbatohet pasi politikat janë bërë publike.

3. E drejta e informimit kufizohet, nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji.
4. E drejta e informimit kufizohet edhe kur, pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar.
5. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kritereve të këtij neni.
6. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuuesit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.
7. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji, pavarësisht nga parashikimet e ligjit për arkivat.

## **KREU V**

### **SHKELJET DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE**

#### **Neni 18**

##### **Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet**

1. Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.
2. Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:
  - a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - b) mosvënja në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
  - c) mosrishikimi i programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë; ç) mosndjekja e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
  - d) moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
  - dh) mosplotësimi i kërkesave për informacione, të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit dhe sipas mënyrës së parashikuar në nenin 9, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - e) mosregjistrimi i kërkesës për informim, moscaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënave të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - ë) mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - f) dërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik kur autoriteti që ka marrë kërkesën e ka informacionin e kërkuar, në kundërshtim me kërkesën e pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - g) mosnjoftimi i kërkuarit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjetër, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
  - gj) mospërcaktimi paraprakisht i një tarife, mospublikimi, ose caktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - h) mosrespektimi i kërkesave të pikës 4, të nenit 13, të këtij ligji, për dhënien falas të informacionit, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
  - i) refuzimi i paarsyetuar i preferencës së kërkuarit për mënyrën e dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e pikës 4, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;
  - j) mosnjoftimi i kërkuarit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 15, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;



- k) moskryerja e njoftimeve paraprake, sipas parashikimeve të nenit 16, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;
  - l) dëmtimi ose shkatërrimi i dokumenteve zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
  - ll) moszbardhja e dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.
3. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

## **Neni 19**

### **Përgjegjësia administrative**

1. Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore -administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “h”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.
2. Në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit në fuqi që rregullon procedurën administrative, titullari i autoritetit publik e delegon kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, te nëpunësi më i lartë civil i autoritetit publik, sipas klasifikimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Në këtë rast, nëpunësi më i lartë civil mban përgjegjësi ligjore për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “gj”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.
3. Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjat “a”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j” dhe “k”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.
4. Çdo nëpunës i autoritetit publik ka përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “l” dhe “ll”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.

## **Neni 20**

### **Marrëdhëniet me Kuvendin**

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale raporton në Kuvend ose në komisionet parlamentare të paktën një herë në vit ose sa herë që kërkohet prej tyre. Gjithashtu, ai mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme. Raporti përmban të dhëna dhe shpjegime për zbatimin e së drejtës për informim në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës.
2. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të kërkuara me vendim të Kuvendit.
3. Gjatë përpilimit të raportit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbledh të dhëna nga autoritetet publike dhe nga organizatat jofitimprurëse që kanë për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke evidentuar komunikimet përkatëse.

## **Neni 21**

### **Mënyra e shlyerjes së masës së dënimit me gjobë**

1. Masa e dënimit, e përcaktuar me gjobë, shlyhet me këste mujore.
2. Këstet mujore caktohen në një masë të tillë që nëpunësit dhe familjes së tij t’i garantohet jetesa, të paktën në nivelin e pagës minimale, të caktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Për shkelje të parashikuara në shkronjat “I” dhe “II”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

## **Neni 22**

### **Ankimi i sanksioneve administrative**

Personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

## **Neni 23**

### **Arkëtimi i shumave të detyrimeve**

1. Vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vendosjen e gjobës i komunikohet titullarit të autoritetit publik dhe zyrës së financës.
2. Gjobat ekzekutohen nga zyra e financës së autoritetit publik, për të cilin punon kundërvajtësi, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit me kërkesë të komisionerit.
3. Gjobat arkëtohen në Buxhetin e Shtetit.

## **KREU VI**

### **KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE**

## **Neni 24**

### **Procedurat për shqyrtimin e ankesave**

1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
  - a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
  - b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
3. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e shoh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.
5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:

- a) mospranimin e ankesës kur:
    - i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;
    - ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
    - iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
  - b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;
  - c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
  - ç) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.
6. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.
7. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk cenon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit".

### **Neni 25** **Ankimi në gjykatë**

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

### **Neni 26** **Shpërblimi i dëmit**

Çdo person, që ka pësuar një dëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar, në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë".

### **Neni 27** **Shfuqizime**

Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", shfuqizohet.

### **Neni 28** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetari

**Ilir META**

Miratuar në datën 18.9.2014

## **VENDIM**

**Nr. 48, datë 21.1.2015**

### **PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri  
**Edi Rama**

# **RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR**

Kjo rregullore bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, në aktet e tjera ndërkombëtare që rregullojnë çështjet e aftësisë së kufizuar, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe akte të tjera të zbatueshme për organet e administratës publike.

## **Neni 1**

### **Parimet e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar**

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në parimin e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, respektit për dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar, barazisë e mos-diskriminimit, barazisë së mundësive, heqjes së barrierave, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes/përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit, si dhe në parimet e tjera, të parashikuara në ligjet bazë për miratimin e kësaj rregulloreje.

## **Neni 2**

### **Përbërja, përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit**

1. Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar përbëhet nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë. Këshilli kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka këtë përbërje:
  - 1 Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kryetar; anëtar;
  - 2 Ministri i Drejtësisë anëtar;
  - 3 Ministri i Shëndetësisë anëtar;
  - 4 Ministri i Arsimit dhe Sporteve anëtar;
  - 5 Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës anëtar;
  - 6 Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit anëtar;
  - 7 Ministri i Financave anëtar;
  - 8 Ministri i Kulturës
  - 9 Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes anëtar;
  - 10 Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike anëtar;
  - 11 Përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara 5 anëtarë;
  - 12 Përfaqësues të organizatave për personat me aftësi të kufizuara 2 anëtarë.

2. Përzgjedhja e anëtarëve përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave për personat me aftësi të kufizuara për Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, bëhet një herë në 4 vjet nga Kryeministri.  
Mënyra e konkurrimit dhe përzgjedhjes përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit, për përbërjen e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
3. Kryeministria, nëpërmjet sekretariatit teknik të Këshillit, pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, njofton menjëherë Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar për çdo kandidat të përzgjedhur.

### **Neni 3** **Funksionet e Këshillit**

Këshilli Kombëtar për Aftësisë së Kufizuar ushtron këto funksione:

- a) Shqyrton dhe miraton planet kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- b) Shqyrton zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për Këshillin e Ministrave.
- c) Shqyrton çështje të aftësisë së kufizuar që nuk kanë gjetur zgjidhje nga ministrinë përkatëse ose kërkojnë koordinim ndërministror dhe jep rekomandime për Këshillin e Ministrave.
- d) Këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- e) Koordinon dhe lehtëson brenda qeverisë veprimet që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar në sektorë të ndryshëm dhe në nivele të ndryshme;
- f) I propozon ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- g) Vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërisë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, nxjerr udhëzime dhe jep rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;
- h) Analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;
- i) Rekomandon shërbime dhe programe që janë posaçërisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
- j) Shërben si organ konsultimi për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e organizmave për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje;
- k) Bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
- l) Jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre.

## **Neni 4**

### **Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të Këshillit**

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi vetëm njëherë, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.
2. Kohëzgjatja në detyrë e anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar fillon me aktin e emërimit të tij/saj, nga Kryeministri.  
Kur vendi i një anëtari mbetet vakant, anëtari që e zëvendëson ushtron mandatin 4-vjeçar.
3. Anëtarët përfaqësues të institucioneve publike në Këshill ushtrojnë detyrën e tyre pa kufizim mandati, deri në zëvendësimin e tyre nga ministrat apo titullarët e institucioneve të tyre dhe miratimin e aktit të emërimit nga Kryeministri.
4. Nëse anëtari/ja i/e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar ka plotësuar mandatin e pare prej 4 vjetësh, Kryeministri fillon procedurën e përzgjedhjes së një përfaqësuesi, 2 muaj përpara përfundimit të mandatit.
5. Nëse anëtari/ja i/e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar paraqet dorëheqjen para mbarimit të mandatit, Kryeministri fillon procedurën e përzgjedhjes së një përfaqësuesi të ri anëtar të Këshillit.
6. Çdo anëtar qëndron në detyrë deri në emërimin e anëtarit vijues në Këshill.
7. Kryeministri kujdeset gjatë procedurës së emërimit të anëtarëve të Këshillit të realizojë përfaqësimin sipas kategorisë së aftësisë së kufizuar, moshës e gjinisë së anëtarit përfaqësues.

## **Neni 5**

### **Përfundimi i qëndrimit në detyrë I anëtarëve të Këshillit**

Qëndrimi në detyrë i anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar përfundon:

- a) me ndryshimin e anëtarit përfaqësues në rastet e organeve shtetërore nga titullari i institucionit;
- b) me plotësimin e afatit 4-vjeçar, në rastet e anëtarëve me mandat, kur nuk është ripropozuar për një mandat të ri;
- c) me dorëheqjen e vetë anëtarit/es së Këshillit, për të cilën duhet të njoftojë me shkrim një javë përpara organin që e ka propozuar;
- d) për mospjesëmarrje në dy mbledhje radhazi;
- e) me vdekjen e tij/saj;
- f) raste të tjera të parashikuara në ligj.

## **Neni 6**

### **Kryetari/ja i/e Këshillit**

1. Kryetari i/e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar është ministri/ja që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar. Kryetari/ja i/e Këshillit drejton mbledhjen e tij, diskutimet në të, duke siguruar zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, dhe në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kryetari i Këshillit përfaqëson Këshillin në marrëdhënie me palë të treta.



## **Neni 7**

### **Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjet e Këshillit**

1. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar, me vendim të Këshillit, mund të ftohen të marrin pjesë, pa të drejtë vote:
  - a) Avokati i Popullit;
  - b) Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
  - c) Ministrat e papërfaqësuar në Këshill;
  - d) përfaqësues të organeve vendore;
  - e) përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara;
  - f) përfaqësues të organizatave për personat me aftësi të kufizuara;
  - g) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të cilat angazhohen në fushën e aftësisë së kufizuar;
  - h) përfaqësues të organizatave të biznesit;
  - i) përfaqësues të medieeve;
  - j) përfaqësues të institucioneve arsimore e shkencore;
  - k) specialistë të administratës publike që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar, në varësi të çështjeve që do të diskutohen;
  - l) nëpunës që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar në administratën publike, qendrore apo vendore;
  - m) ekspertë të çështjeve të aftësisë së kufizuar, si dhe
  - n) ekspertë të tjerë të fushave të ndryshme, rast pas rasti, sipas rendit të ditës.
2. Të drejtën për të propozuar pjesëmarrjen e të ftuarve pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit, me miratim të Kryetarit e kanë:
  - a) anëtarët e Këshillit;
  - b) drejtuesi/ja i/e strukturës për çështjet e aftësisë së kufizuar në ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar/sekretariati teknik I aftësisë së kufizuar i Këshillit;
  - c) secili prej subjekteve të përmendur në pikën 1 të këtij neni, që paraqet kërkesë për këtë qëllim dhe kur Kryetari ka vendosur në agjendë pjesëmarrjen e tyre.
3. Gjatë mbledhjes së Këshillit në të cilën marrin pjesë, pjesëmarrësit pa të drejtë vote ftohen të japin opinione sqaruese dhe sugjerime për çështjet që diskutohen, sipas kërkesave të anëtarëve të Këshillit.

## **Neni 8**

### **Sekretariati Teknik i Këshillit**

1. Sekretariati Teknik i Këshillit krijohet pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe është struktura mbështetëse për Këshillin.
2. Sekretariati Teknik ushtron këto detyra:
  - Koordinon procesin e hartimit të planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
  - përgatit raportin për zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
  - përgatit materialet për takimet e Këshillit, njofton anëtarët e Këshillit për mbledhjet e radhës të Këshillit, mbledh dhe shpërndan informacione për aftësinë e kufizuar, koordinon dhe bash-



kërendon punën me nëpunësit që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar në institucione, mban bazën e të dhënave të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave për personat me aftësi të kufizuara dhe ka marrëdhënie të vijueshme me to, mban procesverbalin gjatë takimit të Këshillit, zbardh dhe shpërndan atë, si edhe ushtron detyra sipas kërkesave të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

## **Neni 9** **Mbledhjet e Këshillit**

1. Këshilli mbledhet të paktën dy herë në vit.
2. Këshilli mund të mbledhet në takime jashtë radhe, nëse kërkohet nga Kryetari i Këshillit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari i Këshillit, i cili vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar të organit kolegjial.
4. Mbledhjet mund të mbahen edhe perms komunikimit elektronik, ndërsa votimet mund të realizohen përmes votimit elektronik apo me vendim qarkullues, kur kjo miratohet nga vetë Këshilli në mbledhjen paraardhëse.
5. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejte vote. Në këtë rast, anëtarët përcaktojnë edhe çështjet që shqyrtohen në mbledhje.
6. Anëtarët e Këshillit njoftohen për thirrjen e mbledhjeve, jo më pak se 15 ditë kalendarike para datës së thirrjes së mbledhjes.
7. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet përmes Sekretariatit Teknik të Këshillit. Njoftimi përmban informacionin mbi datën, kohën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, çështjet dhe dokumentet për të cilat do të diskutohet në mbledhje.
8. Kryetari vendos për agjendën e mbledhjes. Cilido anëtar që dëshiron të shtojë çështje të tjera në agjendë, njofton Kryetarin e Këshillit, perms Sekretariatit Teknik, jo më vonë se 10 ditë para takimit.
9. Mbledhjet e Këshillit janë të vlefshme kur në hapjen e mbledhjes janë të pranishëm më shumë se 1/2 e anëtarëve të Këshillit.
10. Anëtarët që nuk kanë mundësi për pjesëmarrje në takim, njoftojnë Sekretariatit Teknik për mospraninë e tyre, mundësisht, jo më shumë se 5 ditë para takimit.

## **Neni 10** **Shqyrtimi i çështjeve**

1. Kryetari i Këshillit hap mbledhjen fillimisht, duke verifikuar kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe duke lexuar agjendën për të gjithë të pranishmit. Nëse të paktën 2/3 e anëtarëve të Këshillit kërkojnë shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kryetari i shton ato në rendin e ditës.
2. Kryetari i Këshillit fillon shqyrtimin e çështjeve sipas rendit të tyre në agjendë.
3. Anëtarët ftohen fillimisht, të bëjnë pyetje në lidhje me çështjet e rendit të ditës dhe në vijim, ftohen të diskutojnë në lidhje me to. Anëtarët gëzojnë të drejtën të marrin fjalën sa here dëshirojnë gjatë kohës së pyetjeve dhe diskutimeve.
4. Këshilli shqyrton çdo çështje dhe merr vendim për secilën prej tyre në përfundim të diskutimit të saj, para se të fillojë diskutimi për çështjen e radhës.

## **Neni 11**

### **Mbajtja e procesverbalit**

1. Sekretariati Teknik i Këshillit mban procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit në të cilin përfshihen informacione mbi ditën, kohën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, agjendën, të pranishmit, çdo pyetje e diskutim, si nga anëtarët me të drejtë vote ashtu edhe nga të ftuarit, vendimet e marra, përfshirë votat pro e kundër.
2. Për rastet kur kjo është e mundur, procesverbali qarkullon në përfundim të mbledhjes për konfirmim nga të gjithë anëtarët e Këshillit dhe pasqyron çdo ndryshim të kërkuar, në përputhje me mbledhjen, nga anëtarët.
3. Procesverbali, në rastet kur zbardhja e tij është e pamundur, ose Këshilli vendos, qarkullon për miratim elektronikisht, ose në mënyrë tjetër të miratuar nga Këshilli.
4. Në çdo rast, procesverbali miratohet brenda 5 ditëve kalendarike nga dita e mbledhjes së Këshillit.
5. Procesverbali firmoset nga Kryetari i Këshillit dhe punonjësi i Sekretariatit Teknik të Këshillit që mbajtja procesverbalin.

## **Neni 12**

### **Vendimet e Këshillit**

1. Këshilli merr vendim për çdo pikë të agjendës, me përjashtim të rasteve kur vendoset shtyrja e shqyrtimit të çështjes.
2. Vendimet e Këshillit janë të vlefshme kur për to votojnë më shumë se 1/2 e të pranishmëve.
3. Anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje, janë të detyruar të votojnë për çdo çështje, pa gëzuar të drejtën e abstenimit, me përjashtim të rasteve kur kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar.
4. Kryetari i Këshillit voton i fundit.
5. Votimi i çështjeve bëhet i hapur me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligjet në fuqi.
6. Çdo vendim i marrë nga Këshilli zbardhet si I tillë më vete dhe firmoset nga Kryetari i Këshillit.
7. Çdo vendim i Këshillit i paraqitet Kryeministrit dhe për dijeni ministrave përkatës.

## **Neni 13**

### **Ndryshimet e rregullores**

Çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë ndryshime në Rregulloren e Këshillit, të cilat, pasi miratohen, i përcillen Këshillit të Ministrave nga Ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar.

## UDHËZIM

**Nr. 1, datë 2.2.2015**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 8, DATË 14.1.2015 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË, NGA HEQJA E FASHËS DERI NË 300 Kwh PËR FATURIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në zbatim të pikës 6 të vendimit nr. 8, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj", ministri i Energjisë dhe Industrisë, ministri i Financave dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

UDHËZOJNË:

Përfitojnë kompensim për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj: kategoritë e përcaktuara në pikën 1, gjerat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", të vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj".

Fatura e energjisë elektrike për përfituesit e këtij kompensimi do të jetë e njëjtë me faturën e konsumatorëve që nuk e përfitojnë këtë kompensim dhe vlera e saj do të shprehet me çmimin e ri të energjisë elektrike.

Kompensimi për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, si rezultat i heqjes së fashës deri në 300 Kwh bëhet vetëm për një kontratë të energjisë elektrike dhe vetëm për një prej kategorive përfituese të përcaktuara në pikën 1 të vendimit.

#### **I. Familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, familjet, që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, të verbër dhe paraplegjikët e tetraplegjikët.**

1. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore harton listën emërore të personave që përfitojnë këtë kompensim në përputhje me pikën 2 të vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj".

Për përfitimin e këtij kompensimi, aplikuesi së bashku me deklaratën, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, duhet të paraqesë pranë administratorit shoqëror:

- a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit;
- b) certifikatën familjare;
- c) fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.

2. Familjet, që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar së bashku me deklaratën sipas aneksit 1, duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:
  - a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit;
  - b) certifikatën familjare që vërteton se personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar;
  - c) për anëtarët madhorë të familjes vërtetimin nga Zyra e Punës që janë punëkërkues të papunë;
  - d) fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara;
3. Të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët së bashku me deklaratën sipas aneksit 1 duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:
  - a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit;
  - b) certifikatën familjare;
  - c) fotokopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose fotokopjen e vendimit të KMCAP-it / KMPV;
  - e) fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.
4. Lista e hartuar nga administratori shoqëror miratohet nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore.
5. Zyra e Financës e Njësisë së Qeverisjes Vendore e pasqyron pagesën e kompensimit për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike në një kolonë të veçantë krahas asaj të ndihmës ekonomike. Në rastet kur kompensimin e përfiton direkt personi me aftësi të kufizuar, pagesa pasqyrohet në një kolonë të veçantë në pagesën e kësaj kategorie.
6. Zyra e Financës e Njësisë së Qeverisjes Vendore ku po pilotohet skema e re e Ndihmës Ekonomike e pasqyron pagesën e kompensimit për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike në një bordero të veçantë. Në rastet kur kompensimin e përfiton direkt personi me aftësi të kufizuar, pagesa pasqyrohet në një kolonë të veçantë në pagesën e kësaj kategorie.
7. Njësitë e Qeverisjes Vendore paraqesin kërkesat për fonde në Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të cilat pasi bëjnë verifikimet e nevojshme i dërgojnë këto kërkesa në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Procedurat e mëtejshme janë të njëjta me ato që zbatohen për fondet e ndihmës e ekonomike apo fondet për pagesat e aftësisë së kufizuar. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë paraqet pranë Ministrisë së Financave detajimin vjetor në nivel mujor të fondit të kompensimit të energjisë elektrike për çdo njësi të qeverisjes vendore, në të njëjtën mënyrë si veprohet për fondet e ndihmës e ekonomike apo fondet për pagesat e aftësisë së kufizuar.

## **II. Kryefamiljarë që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension pleqërie.**

1. Lista emërore e pensionistëve kryefamiljarë që përfitojnë pension pleqërie ose pension invaliditeti sipas pikave “b” dhe “c” të vendimit të sipërshënuar, që përfitojnë kompensimin e çmimit të energjisë elektrike për shkak të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KWh, përcaktohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat rajonale në varësi të tij, bazuar në deklaratën personale të përfituesit, sipas modelit bashkëlidhur.

Së bashku me deklaratën sipas aneksit 2 bashkëlidhur, kryefamiljari pensionist/invalid duhet të paraqesë pranë agjencive lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit:

- a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit;
  - b) certifikatën familjare për invalidët;
  - c) për anëtarët madhorë të familjes vërtetimin nga Zyra e Punës që janë punëkërkues të papunë.
  - d) fotokopjen e librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.
2. ISSH-ja bazuar në listat e përfituesve harton pasqyrat përmbledhëse të kompensimeve, të detajuar

sipas muajve për çdo drejtori rajonale në bazë qarqesh dhe paraqet kërkesën për fonde për financimin e pagesave pranë MMSR-së. Bazuar në kërkesën e drejtuar nga ISSH-ja, MMSR-ja bën çeljen e fondeve për llogari të ISSH-së, pranë degës së Thesarit Tiranë dhe autorizon atë për tërheqje. Shpërndarja e fondeve sipas Drejtorive Rajonale dhe zyrave të pagesës në qarqe, bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Kompensimi për pensionistët/invalidët realizohet nga qendra e pagesës së pensioneve sipas gjenerimeve në portalin informatik të pagesave të pensioneve ose mbi bazën e urdhërpagesës së listuar, e cila përgatitet nga strukturat rajonale të ISSH-së. Dokumentimi i pagesës faktike të kompensimit bëhet në një listë pagesë të veçantë, e cila nënshkruhet nga përfituesi në emër të tij dhe nga qendra paguese/Posta Shqiptare sh.a.
4. Kompensimi i diferencës së çmimit të energjisë elektrike për shkak të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KwH, fillon nga data 1.2.2015 dhe i përgjigjet energjisë elektrike të shpenzuar nga data 1.1.2015. Me qëllim që gjenerimi dhe pagesa e kompensimeve në favor të përfituesve të kryhet pa krijuar shqetësime, fillimisht nga ISSH-ja, si dokumente që përcaktojnë të drejtën e përfitimit janë të vlefshme ato dokumente të cilat shërbejnë për dhënien e kompensimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 9.8.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”. Rideklarimi për efekt të përfitimit të kompensimit sipas VKM nr. 8/2015 dhe vlerësimi i kushteve për vazhdimin e kompensimit do të bëhet brenda tre muajve nga fillimi i pagesave, duke bërë edhe sistemimin e efekteve financiare në rast të përfitimeve të padrejta. Përfituesit e rinj kualifikohen për përfitim vetëm pas deklarimit dhe dorëzimit të dokumenteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu. Në këto raste, e drejta e përfitimit të kompensimit fillon nga data 1.2.2015, por me kushtin që deklarimi të jetë bërë brenda datës 27.4.2015. Në raste të tjera e drejta e kompensimit do të fillojë nga muaji që bëhet deklarimi dhe dorëzohen dokumentet.

### **III. Kryefamiljarët që janë punonjës buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 mijë lekë në muaj**

1. Përcaktimi i përfituesve do të bëhet nga institucionet përkatëse buxhetore ku përfituesit marrin pagën bruto nën 35 mijë lekë. Në fillim të procesit të përcaktimit të përfituesve dhe sa herë që ndryshojnë kushtet për përfitim, personat përfitues të këtij kompensimi së bashku me deklaratën personale duhet të paraqesin pranë strukturës përkatëse të burimeve njerëzore:
  - a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit;
  - b) certifikatën familjare që vërteton se punonjësi buxhetor është kryefamiljar;
  - c) për anëtarët madhorë të familjes vërtetimin nga Zyra e Punës që janë punëkërkues të papunë;
  - d) fotokopjen e librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.
2. Institucionet buxhetore për punonjësit në institucionet buxhetore japin dhe përballojnë kompensimin për punonjësit e tyre dhe i përballojnë nga fondet buxhetore të miratuara për institucionin e tyre.

Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, njësitë e qeverisjes vendore dhe të gjitha institucionet buxhetore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Financave

**Shkëlqim Cani**

Ministri i Energjisë dhe Industrisë

**Damian Gjijnuri**

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

**Erion Veliaj**

**DEKLARATË****(Aneks 1)****Për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj**

I nënshkruari .....deklaroi nën përgjegjësinë time personale sa vijon:

Jam përfitues i pagesës së NE / AK<sup>1</sup> ..... në njësinë e qeverisjes vendore.....

Jam banor .....  
(shënohet adresa e plotë)

Kontrata me degën e shitjes së energjisë ka numrin.....

(shënohet numri që vendoset në faturën mujore të energjisë)

Përbërja familjare në datën ..... është si më poshtë

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Lidhja me k/familjarin	Datëlindja dita, muaji, viti	Aktiviteti që kryen	Ku ndodhet aktualisht

1. Deklaroj se nuk kam njeri nga familja në punë a në pension?

2. Deklaroj se kam vetëm kontratën me numrin e sipërsbënuar

3. Deklaroj se nuk kam detyrime të papaguara ndaj degës së shitjes së energjisë elektrike.

4. Deklaroj se të dhënat janë të vërteta dhe se jam përgjegjës ligjrisht në rast se vërtetohet e kundërta.

5. Unë do të kthej kompensimin dhe do të mbaj përgjegjësi sipas ligjit në rast se të dhënat që deklarova nuk janë të sakta.

6. Deklaroj se në rast të punësimit të anëtareve të familjes apo në rast se familja do të ketë të ardhura të tjera apo ndryshime që përjashtojnë kompensimin do të deklaroi për heqjen e tij në të kundërt mbaj të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga mos deklarimi.

**DEKLARUESI****ADMINISTRATORI SHOQËROR**

.....

.....

Për personat mbi 18 vjeç deklarata shoqërohet me vërtetim nga zyra e punës, si edhe me certifikatë familjare.

**DEKLARATË****(Aneks 2)****Për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj**

I nënshkruari .....deklaroi nën përgjegjësinë time personale sa vijon:

Jam ..... me nr. pensioni..... dhe marr pension në QP .....

Jam banor i lagjes.....  
(shënohet adresa e plotë)

Kontrata me degën e shitjes së energjisë ka numrin.....

(shënohet numri që vendoset në faturën mujore të energjisë)

Përbërja familjare në datën ..... është si më poshtë

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Lidhja me k/ familjarin	Datëlindja dita, muaji, viti	Aktiviteti që kryen	Ku ndodhet aktualisht



1. Deklaroj se nuk kam njeri nga familja në punë a në pension
2. Deklaroj se kam vetëm kontratën me numrin e sipërsbënuar
3. Deklaroj se nuk kam detyrime të papaguara ndaj degës së shites së energjisë elektrike.
4. Deklaroj se të dhënat janë të vërteta dhe se jam përgjegjës ligjërish në rast se vërtetohet e kundërta.
5. Unë do të kthej kompensimin dhe do të mbaj përgjegjësi sipas ligjit në rast se të dhënat që deklarova nuk janë të sakta.
6. Deklaroj se në rast të punësimit të anëtareve të familjes apo në rast se familja do të ketë të ardhura të tjera apo ndryshime që përjashtojnë kompensimin do të deklaroj për heqjen e tij në të kundërt mbaj të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga mos deklarimi.

**DEKLARUESI**

**INSPEKTORI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Për personat mbi 18 vjeç deklarata shoqërohet me vërtetim nga zyra e punës si edhe me certifikatë familjare.

**DEKLARATË (Aneks 3)**

**Për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj**

I nënshtetuesi .....deklaroi nën përgjegjësinë time personale sa vijon:

Jam punonjës buxhetor pranë.....

Jam banor .....

(shënohet adresa e plotë)

Kontrata me degën e shites së energjisë ka numrin.....

(shënohet numri që vendoset në faturën mujore të energjisë)

Përbërja familjare në datën ..... është si më poshtë

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Lidhja me k/ familjarin	Datëlindja dita, muaji, viti	Aktiviteti që kryen	Ku ndodhet aktualisht

1. Deklaroj se nuk kam njeri nga familja në punë a në pension
2. Deklaroj se kam vetëm kontratën me numrin e sipërsbënuar
3. Deklaroj se nuk kam detyrime të papaguara ndaj degës së shites së energjisë elektrike.
4. Deklaroj se të dhënat janë të vërteta dhe se jam përgjegjës ligjërish në rast se vërtetohet e kundërta.
5. Unë do të kthej kompensimin dhe do të mbaj përgjegjësi sipas ligjit në rast se të dhënat që deklarova nuk janë të sakta.
6. Deklaroj se në rast të punësimit të anëtareve të familjes apo në rast se familja do të ketë të ardhura të tjera apo ndryshime që përjashtojnë kompensimin do të deklaroj për heqjen e tij në të kundërt mbaj të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga mos deklarimi.

**DEKLARUESI**

**DREJTUESI I INSTITUCIONIT**

Për personat mbi 18 vjeç deklarata shoqërohet me vërtetim nga zyra e punës, si edhe me certifikatë familjare.

## **UDHËZIM**

**Nr. 7, datë 25.2.2015**

### **PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 10.3.2014 “PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE TË PAGESAVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar”, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014 , datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të ndryshuar dhe pikës 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit, dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”, të vendimit nr 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, udhëzimit nr 2, datë 6.2.2012, të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimit plotësues nr. 2, datë 9.1.2015 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit 2015”,

#### UDHËZOJ:

1. Në pikën 3, paragrafi i dytë riformulohet me këtë përmbajtje:  
“Për të gjitha kategoritë mbahen parasysh pagesat e diferencuara që përfitojnë individë të veçantë për periudhën kur ndjekin arsimin e mesëm, të lartë apo pasuniversitar, pagesave për kompensimin financiar për energjinë elektrike, telefoninë fikse, pagesave për kompensimin për heqjen e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike, pagesën për paketën higjieno-sanitare.  
Të dhënat e mësipërme plotësohen sipas mod. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi”.
2. Në pikën 10, shprehja “sipas pikës 8”, zëvendësohet me shprehjen “sipas pikës 9”.  
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
**Erion Veliaj**



QARKU \_\_\_\_\_  
 BASHKIA, KOMUNA \_\_\_\_\_

Programimi i fondeve për pagesat e aftësisë së kufizuar

Datë, më \_\_\_\_\_

Nr	Emërtimi	Numri i personave PAK	Masa e pagesës	Fondi vjetor
<b>I</b>	<b>Personat me aftësi të kufizuar gjithsej (a+b+c) + kujdestar</b>			
<b>1</b>	<b>Me aftësi të kufizuar mendore, fizike gjithsej (a+b+c)</b>			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
<b>d</b>	<b>Kujdestarë gjithsej</b>			
	100%			
	150%			
<b>II</b>	<b>Të verbër gjithsej (a+b+c+d)+ kujdestar</b>			
<b>2</b>	<b>Të verbër gjithsej (a+b+c+d)</b>			
a	100%			
b	150%			
c	200%			
d	300%			
	<b>Numri kujdestarëve</b>			
	Kompensim energjie verbër me kujdestar			
	Kompensim energjie verbër pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për të verbër gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri 300kwh			
<b>III</b>	<b>Para e tetraplegjik+kujdestar+pakete H.S</b>			
<b>3</b>	<b>Para e tetraplegjik, gjithsej</b>			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
<b>d</b>	<b>Kujdestarë gjithsej</b>			
	100%			
	150%			
<b>e</b>	<b>Paketa hijeno-sanitare</b>			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik me kujdestar			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për para e tetraplegjik gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri në 300kwh			
<b>IV</b>	<b>Nr. i invalidëve gjithsej (a+b+c+d)</b>			
a	Sëmundje e përgjithshme, grupi I			
b	Sëmundje e përgjithshme, grupi I I			
c	Sëmundje profesionale, grupi I.			
d	Sëmundje profesionale, grupi II			
	<b>Totali i PAK</b>			

ADMINISTRATORI

KRYETARI

## UDHËZIM

**Nr. 9, datë 25.2.2015**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 404, DATË 20.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE"**

Mbështetur në pikën 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse",

#### UDHËZOJ:

1. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.
2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.
3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj.
4. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.
5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.
6. Kompensimi për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse është një pagesë mujore e cila llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

7. Përfituesit, objekti i këtij udhëzimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar.
8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, individët, së bashku me deklaratën duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Kopjen e nënshkruar të kartës së identitetit;
  - b) Certifikatë familjare, që vërteton se individi është anëtar i familjes;
  - c) Kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila vërteton që nuk ka detyrime të prapambetura;
  - ç) Kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila vërteton që nuk ka detyrime të prapambetura;
  - d) Kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të KMCAK/KMPV.
  - dh) Kontratën e qirasë të lidhur sipas nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kreu VI “Qiraja”, e cila duhet të përmbajë edhe numrin e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike dhe kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse.
9. Njësitë e qeverisjes vendore shpërndajnë çdo muaj pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose «Posta Shqiptare» sh.a.
10. Administratori shoqëror harton kërkesën për fonde për masën e financimit të kompensimit financiar të faturës së energjisë elektrike dhe faturës së telefonisë fikse dhe e bën pjesë të kërkesës së planifikimit të fondeve për aftësinë e kufizuar çdo dy muaj dhe e paraqesin pranë zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
**Erion Veliaj**

## **UDHËZIM**

**Nr. 22, datë 20.08.2015**

**MBI**

### **ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 07.09.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR” TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 27 të Vendimit Nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar:

UDHËZOJ:

Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM, Nr. 618, datë 07.09.2006, bëhet 10.030 (dhjetëmijë e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM, Nr. 618, datë 07.09.2006, bëhet 10.030 (dhjetëmijë e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.530 (dhjetëmijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 Shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet akorduar për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Udhëzimi nr. 13, datë 29.9.2014 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 01.09.2015.

Ministër  
**Blendi Klosi**

## **UDHËZIM**

**Nr.23, datë 20.08.2015**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR"**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 31, datë 20.01.2001, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar:

#### **UDHËZOJ:**

Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.31, datë 20.01.2001, bëhet 10.030 (dhjetëmijë e tridhjetë) lekë në muaj.

Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.31, datë 20.01.2001, bëhet 10.530 (dhjetëmijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në muaj.

Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 Shtator i vitit 2015 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Udhëzimi nr. 12, datë 29.9.2014 i Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 01.09.2015.

Ministër

**Blendi Klosi**

## **UDHËZIM**

**Nr.24, datë 20.08.2015**

### **MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.06.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT, TË NDRYSHUAR"**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 16 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 277, datë 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", i ndryshuar:

#### **UDHËZOJ:**

Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 277, datë 18.06.1997, bëhet 11.390 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 Shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Udhëzimi nr. 14, datë 29.9.2014 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 01.09.2015.

Ministër

**Blendi Klosi**

## **URDHËR**

**Nr. 343, datë 19.8.2013**

### **PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE NORMATIVE PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 73 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e dispozitave normative për sistemin a simor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitare në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe njësitë arsimore vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

**Myqerem Tafaj**

Botim i Fondacionit Shqiptar për të  
Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Adresa: Rr. "Bogdani", P.15-të, kati 3-të, Tiranë

Tel/Fax: +3554 269426

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

E-mail: [adrf@albmail.com](mailto:adrf@albmail.com)